Franz Kafka
Letër babait
me pasthënie nga Georges Bataille

Në "Letër babait", e shkruar në nëntor 1919, që iu besua nënës, avarësisht se kurrë nuk i ra në dorë letërmarrësit, Kafka, si kurrë donjëherë, na ka dhënë një portret kaq të qartë të vetvetes.

Dhe shumë nga motivet që preken në këtë rrëfim mizorisht të nqertë, sidomos ai i "ndjenjës së tejskajshme të fajit", s'mund ios të të sjellin ndërmend personazhet e tij më të spikatur.

Ajo që shpaloset përbën një konflikt të mirëfilltë. Babai, kjo gurë që mishëron autoritet të gjithëpushtetshëm, që "ka pamjen nigmatike të tiranëve, ligji i të cilëve i ka rrënjët te figura e ersonit, jo te mendimi", në sytë e Kafkës shfaqet si përfaqësues pik i një bote praktike e pragmatiste, ku fitimi është qëllimi i etëm, botë që është larg aspiratave të tij dhe nga e cila ndihet i ërjashtuar. Në faqet ku ngarkesa emotive është më e fuqishme, afka zbulon natyrën e tij prej "djali plangprishës", të dënuar nga ati, me prirje prej shkrimtari, që nuk kuptohen nga të tjerët, i azuar dhe përherë në kërkim të konfirmimit, ndërkohë që undërshtari i tij tejçon siguri.

Në esenë që shoqëron këtë vepër, Georges Bataille heton në ënyrë provokuese mbi këtë kundërshti.

Historia e Kafkës jep shkas për të ngritur pyetjen në lidhje me ensin e fundmë të letërsisë. Ndoshta asnjë shkrimtar si ai, nuk ka itur të tregojë sesi ky sens është mishërim i vetë jetës.

SBN 99927 - 42 - 12 - 7

PHOENIX

ë kopertinë:Franz Kafka
rchiv Klaus Wagenbach Berlin

500 Lekë

BIBLIOTEKA
821-112

Franz Kafka
Letër babait
me pasthënie nga Georges Bataille

PHOENIX

nga e njëjta seri

G.G. Marquez
Kronikë e një vdekjeje të paralajmërur

F. M. Dostojevski
Net të bardha

Vercors
Heshtja e detit

Julio Cortázar
Armët e fshehta

FRANZ KAFKA

letër babait

e përktheu
Agim Doksani

BIBLIOTEKA
UAM
Nr Inv 2837

PHOENIX

Titulli në origjinal
Brief an den Vater

Botimi i parë 2000 **PHOENIX**
©PHOENIX

Kopertina
Konceptoi: Artan Raça
Realizoi: Kleida Maluka

CIP Katalogizimi në botim. B.K. Tiranë
Kafka, Franz
Letër babait/Franz Kafka; Pasthënia Georges Bataille; Përkth.
Agim Doksani. -Tiranë: Phoenix, 2000
96 f.; 20 cm
Tit. i origjin.: Brief an den Vater
ISBN 99927 - 42 - 12 - 7
821.112.2-6
821.112.2.09
1. Letrat (letërsia) gjermane 2. Kafka, Franz, 1883-1924 - Kritika, interpretimi
3. Kafka, Franz, 1823 - 1924 - Marrëdhëniet familjare

LENDA

7 letër babait
72 SHËNIME
75 kafka nga Georges Bataille
94 SHENIME

Franc Kafka lindi në Pragë, më 1883, nga një familje tregtarësh hebrej. Kreu studimet në jurisprudencë dhe më 1908 gjeti punë pranë një instituti sigurimesh.

Figurë e sfilitur dhe e vetmuar. Jeta e tij përshkohet nga një marrëdhënie e vështirë me të atin (*Letër drejtuar babait,* 1919), ndërsa në marrëdhëniet sentimentale me Felice Bauer, Milena Jasenka dhe shoqen e tij të fundit Dora Dymant kërkon një qëndrueshmëri të pamundur (*Letër dërguar Felicies*, 1912 – 1917; *Letër dërguar Miłenës*, 1920 – 1923). Libri i parë, *Meditim (1908)*, një përmbledhje prozash të shkurtra e ndjekin tregimet *Dënimi (1913)*, *Metamorfoza (1915)*, *Në koloninë ndëshkimore (1919)*.

Shkrimtar që si rrallëkush ka ndjerë nevojën për të shkruar si formë shpëtimi, i beson mikut dhe biografit Maks Brod një numër të madh veprash të pabotuara me qëllim që t'i zhdukte pas vdekjes së tij. Por Brodi i botoi. U botuan, kështu, pas vdekjes, tre romanet e shkruar gjatë dhjetëvjeçarit 1912 – 1922, që ishin të papërfunduar: *Kështjella (1922)*, *Procesi (1925)* dhe *Amerika (1927)*. Në sajë të Brodit u botuan edhe edicionet e para të *Ditarëve (1910 - 1923)*, cikli me tregime *Gjatë ndërtimit të murit kinez (1914 – 1924)* dhe tekste të ndryshme që përmbajnë fragmente, aforizma, përsiatje filozofike, ku mund të përmendim *Tetë fletore në të tetën (1916–1918)* dhe *Vlerësime mbi moralin, dhimbjen, shpresën, rrugën e vërtetë (1917-1918)*. Pas një sëmundje të gjatë, Kafka vdiq në sanatoriumin e Kirlingut, në afërsi të Vjenës, më 1924.

letër babait[1]

I dashur baba!

Kohët e fundit rasti e ka sjellë të më pyesësh se përse kam frikë prej teje. Si zakonisht, s'kam ditur të të përgjigjem dhe kjo pasi, nga njëra anë, më kall frikën dhe nga ana tjetër, sepse, po të gjeja arsyen e kësaj ndjesie do të më duhej të hyja në të thella, shumë më tepër sesa do të më lejonte një letërkëmbim i thjeshtë. Duhet ta dish se, nëse po përpiqem të të përgjigjem duke të shkruar një letër, kjo do të jetë një përgjigje tejet e varfër, sepse edhe kur shkruaj ndihem i kapluar nga frika që më ke kallur dhe nga pasojat e saj; nga ana tjetër, diapazoni i gjerë i temës qëndron shumë më lart se kujtesa dhe inteligjenca ime.

Për ty problemi ka qenë gjithnjë tejet i thjeshtë, të paktën kur flisnim mbarë e prapë, së bashku, apo me të tjerët. Sipas teje, gjërat qëndrojnë përafërsisht kështu: gjithë jetën ke punuar si kalë, duke sakrifikuar gjithçka për bijtë e tu, dhe sidomos për mua; nga ky këndvështrim unë paskam jetuar pa kokëçarje, i lirë të studioja ç'të më donte qejfi, pa e vrarë mendjen për anën financiare, me fjalë të tjera, pa e vrarë mendjen për asgjë. Në shkëmbim, nuk ke kërkuar të ta di për nder, pasi e njeh "mirënjohjen e bijve", por të

paktën një lloj dhembshurie, një shenjë simpatie; ndërsa unë gjithnjë paskam bishtnuar, duke u strukur në dhomën time, mes librave dhe miqve të mi kokëshkretë, plot ide të çuditshme që më gumëzhinin në kokë. Kurrë s'të paskam folur me zemër në dorë, s'të paskam shoqëruar në tempull, nuk paskam ardhur të të takoj në Franzenbad, nga ana tjetër, nuk paskam ushqyer kurrë ndjenjën familjare, nuk qenkam marrë me dyqanin dhe biznesin tënd, punët e fabrikës t'i paskam lënë mbi kurriz dhe i paskam braktisur fare; kam përkrahur kokëfortësinë e Otlës[2] dhe për ty nuk e vikam fare ujin në zjarr (as një biletë teatri nuk të kam gjetur), ndërkohë që për miqtë qenkam bërë copë. Duke e përmbledhur gjykimin tënd për mua, del që ti nuk më akuzon për sjellje të këqija apo veprime të padenja (ndoshta, me përjashtim të planit tim të fundit për t'u martuar), por më akuzon për ftohtësi, indiferencë, mosmirënjohje. Dhe këto m'i përplas në fytyrë sikur vetëm unë qenkam fajtori në këtë mes, sikur me një shkop magjik do të mund të ndreqja gjithçka, ndërsa ti nuk paske kurrfarë faji, përveçse je sjellë me mua më mirë se ç'duhej.

Këtë mendim që të është ngulur në kokë e quaj të ligjshëm në kuptimin që edhe unë, për sa i takon ftohtësisë që ka zënë vend mes nesh, dua të besoj se ti nuk ke kurrfarë faji. Por unë jam tërësisht i pafaj, po aq sa edhe ti. Nëse do arrija të të bindja ta pranoje këtë, ndoshta, do të zinte fill, nuk them një jetë e re, pasi të dyve na ka kaluar mosha për një gjë të tillë, por të paktën një lloj armëpushimi dhe, nëse qortimet e tua pa fund nuk do të reshtnin, të paktën do

të pakësoheshin disi.

E megjithatë një lloj parandjenje, për atë çka dua të shpreh, ti, çuditërisht, e ke. Për shembull, para ca kohësh më the: "Gjithnjë të kam dashur, edhe pse sjellja ime, në dukje, ndryshon nga ajo e baballarëve të tjerë, pikërisht sepse nuk di të shtirem si të tjerët." E mirë, baba, po e pranoj se kurrë nuk kam dyshuar në dashurinë tënde ndaj meje, veç këtë pohim e quaj të gabuar. Ti nuk shtiresh, kjo është e vërtetë, por të pranosh vetëm duke u bazuar në faktin se baballarët e tjerë shtiren, më duket kapadaillëk i tepruar, ose-dhe sipas meje kjo është e vërteta - ekziston përshtypja e kamufluar e diçkaje që nuk shkon ndërmjet nesh, për shkakun, por jo për fajin tënd. Nëse është kjo çka ke ndërmend, atëherë jemi në rregull.

Padyshim nuk them se jam bërë i tillë vetëm për shkakun tënd. Ky do të ishte një teprim i tejskajshëm (edhe pse prirem t'i mëshoj këtij aspekti). Ka shumë gjasa që edhe po të isha rritur plotësisht i çliruar nga ndikimi yt, për ty kurrë nuk do të isha në lartësinë e duhur. Jam thuajse i sigurt se, sidoqoftë sërish do të isha shëndetlig, i lëkundur, i trazuar e plot ankthe, s'do t'i shëmbëlleja as Robert Kafkës as Karl Hermanit, gjithsesi do të isha shumë më i ndryshëm nga ç'jam në realitet dhe sigurisht do të binim në ujdi. Do të isha i lumtur të të kisha shok, shef, xhaxha apo gjysh, madje (megjithëse dyshoj për këtë) edhe vjehrr. Ndërsa pikërisht si baba ke qenë tepër i ashpër me mua, mbase edhe për faktin se vëllezërit e mi vdiqën që fëmijë, motrat lindën shumë më vonë dhe m'u desh t'i përballoj i vetëm

dallgët e para, por ja që isha tejet i brishtë për këtë.

Mjaft të krahasohemi me njeri tjetrin: po i bie shkurt, unë një Lowy[3], me tharm prej Kafke ndër deje, që gjithsesi nuk udhëhiqet nga impulsi vital, afarist dhe luftarak i Kafkave, por nga cytjet Lowyjane që veprojnë me mefshtësi e nën rrogoz, për të mos thënë që mungojnë krejtësisht. Ndërsa ti je një Kafka i vërtetë, për nga forca, shëndeti, oreksi, kumbimi i zërit, oratoria, këmbëngulja; i aftë për t'i dalë zot vetvetes, për të njohur njerëzit, je plot shpirt dhe bujari; sigurisht me vlerat dhe mangësitë që shoqërojnë cilësi të tilla, drejt të cilave të shtyjnë karakteri dhe ndonjëherë edhe gjaknxehtësia.

Ndoshta sipas konceptimit tënd për botën nuk je Kafka i vërtetë, nëse të krahasoj me xhaxha Filipin, Ludvigun apo Heinrihun. Është e çuditshme dhe nuk arrij ta kuptoj përse. Ata ishin të gjithë më të gëzuar, më të gjallë, më të natyrshëm, më të shpenguar, jo aq të rreptë sa ti (në këtë pikë kam marrë shumë nga ti, duke e përdorur më së miri këtë trashëgimi, pa ndjerë në karakter kundërpeshat e nevojshme që ti zotëron). Në këtë kuptim, edhe ti ke kaluar periudha të ndryshme, ndoshta ke qenë më i hareshëm para se bijtë e tu, dhe veçanërisht unë, të të zhgënjenin dhe angushtonin brenda mureve të shtëpisë (bëheshe tjetër njeri, kur kishim të ftuar në shtëpi) dhe ndoshta tani të teptis hareja, tani që nipat dhe dhëndri të kanë dhënë një pjesë të asaj ngrohtësie që bijtë, ndoshta me përjashtim të Valit, s'ditën të ta japin. Sidoqoftë ishim kaq të ndryshëm në ndryshueshmëri, kaq të rrezikshëm për njëri-tjetrin, saqë,

nëse do të ishte e mundur të parashikohej sjellja e ndërsjellë e fëmijës gjatë rritjes së tij të ngadaltë - unë - dhe e burrit të pjekur –ti-, del që do të më kishe zgërlaqur, pa më lënë as nam, as nishan. Por kjo nuk ndodhi, historitë e ekzistencës nuk mund të parashikohen, megjithëse ndoshta ka ndodhur diçka më e keqe. Në këtë pikë do të të lutesha të mbaje parasysh se as që më shkon nëpër mendje të ta hedh fajin ty. Ti ke ndikuar tek unë ashtu siç duhej të ndikoje, vetëm se duhet ta heqësh nga mendja që ta trajtosh si diçka qëllimkeqe nga ana ime, faktin që trysnia e këtij ndikimi më vuri përfund.

Isha fëmijë frikacak; por edhe kokëfortë, siç janë fëmijët. Padyshim, mamaja m'i plotësonte tekat, por nuk mund ta besoj se kam qenë kaq i hazdisur, s'mund ta besoj se një fjalë e ngrohtë, një vështrim i përdëllyer, duke më marrë qetësisht për dore, të mos e platitnin qenien time dhe të arrije çka dëshiroje. Dhe ti, në thelb, je njeri babaxhan dhe i dhembshur (ato çka po them nuk bien në kundërshti, flas vetëm për përshtypjen që kisha krijuar për ty në vogëli), por jo të gjithë fëmijët janë aq këmbëngulës dhe të guximshëm që të rendin kaq gjatë pas dashurisë, deri sa ta gjejnë atë. Ti di ta trajtosh një fëmijë vetëm sipas midesë tënde, gjithë forcë, rrapëllimë e nerva të cingërisura dhe, në rastin tim, kjo të dukej kaq e qëlluar, pasi doje të shihje tek unë një djalosh të fortë e guximplotë.

Sot, është e qartë, arrij t'i përshkruaj vetëm tërthorazi metodat edukative që përdorje në hapat e parë të jetës time, por, sidoqoftë, arrij t'i ravijëzoj sërish në mendje duke

patur parasysh periudhat e mëvonshme dhe mënyrën si sillesh me Feliksin[4]. Veç kësaj duhet mbajtur parasysh se atëherë ishe mjaft më i ri, pra më i fuqishëm, më energjik, më i shpërqendruar, ishe më pak i kujdesshëm nga ç'je tani dhe i përpirë nga puna jote; mezi të shihja një herë në ditë dhe përshtypja që ngjallje tek unë ishte e thellë dhe kurrë nuk u nemit e s'u bë monotone.

Nga vitet e para të jetës ndërmendësoj vetëm një ndodhi. Ndoshta e kujton edhe ti. Një natë qaravitesha paprerë, sepse doja ujë, sigurisht jo për shkak të etjes, por ndoshta për të të bezdisur dhe për t'u zbavitur. Meqë kanosjet fjalërënda s'kishin bërë punë, më ngrite nga shtrati, më nxore në ballkon, mbylle derën dhe më le aty, për pak çaste, vetëm, në fill të këmishës. S'dua të them se nuk veprove drejt, ndoshta atë natë, me të vërtetë s'ia dilje dot ndryshe që të preheshe në paqë, desha vetëm të të përshkruaj mënyrat e tua edukative dhe vragat që lanë mbi mua. Ai ndëshkim, sigurisht, më bëri më kokulur, por më trallisi në thellësi të shpirtit. Kurrë nuk arrita të vë në kandar ujin që kërkoja, kokëngjeshur si mushkë, dhe frikën pa anë e pa fund që ndieja teksa gjendesha jashtë. Edhe vite më vonë më kallte datën fantazia brejtëse sikur burri i stërmadh, im atë, vendi i fundit ku mund të përplasja kokën, mund të vinte natën, pa kurrfarë shkaku dhe të më nxirrte vrikthi, nga shtrati në ballkon; pra, për të, s'isha veçse një zero me xhufkë.

Atëherë ky qe vetëm fillimi, por ndjesia e hiçit, që shpesh më kaplon të tërin (ndjesi që në rrethana të tjera është

madje fisnike e produktive), e ka zanafillën sidomos në ndikimin tënd. Do të kisha patur nevojë për dikë që të më jepte zemër, për pak mirësjellje që do të ma lehtësonte udhën, ndërsa ti, qëllimisht më fusje shkopinj në rrota, edhe pse e bëje pa të keq, që të merrja një tjetër udhë. Por ja që nuk isha i zoti. Për shembull, më lëvdoje kur përshëndesja siç duhej dhe marshoja me hap të rregullt, por unë s'isha tip për ushtar; ose më jepje zemër kur haja si ka, madje kur pija edhe birrë, kur nëpërdhëmbja këngë që s'i kuptoja apo përsëritja si papagall thëniet e tua të parapëlqyera, por asgjë nga këto s'kish të bënte me të ardhmen time. Dhe është kuptimplotë fakti që, edhe sot e kësaj dite, më përkrah vetëm në çështje që kanë të bëjnë me ty, kur e lëndoj sadopak krenarinë tënde (fjala vjen, planet e mia për martesë), apo kur cënoj krenarinë time (kur Pepa[5] më hedh ndonjë fjalë fyese). Në këto raste më jep zemër, më ve në dukje vlerat, më flet për partitë ku duhet të synoja të hyja, ndërsa Pepa dënohet pa të drejtë apelimi. Por edhe po të lëmë mënjanë faktin që në moshën time këto lloj nxitjesh s'pinë më ujë, si mund të jenë të vlefshme për mua, kur bëhet fjalë për gjëra që nuk më prekin drejtpërdrejt?

Asokohe, sidomos asokohe, kisha nevojë për të tilla nxitje. Dilte e tepronte pamja jote fizike, të cilën ma shpalosje plot kapadaillëk. Sjell ndërmend, për shembull, kur zhvisheshim në të njëjtën kabinë plazhi. Unë hollak, i brishtë, ti i gjatë e hijerëndë. Edhe aty brenda në kabinë ndihesha ligsht, jo vetëm para teje por para botës mbarë, sepse ti për mua ishe masa e gjithçkaje. Më kujtohet kur

dilnim mes njerzve dhe ti mbaje për dore një skilipec të mërdhihur e këmbëzbathur, që i shkonin shtatë nga uji, i pazoti për të imituar lëvizjet e notit që ti këmbëngulje të më mësoje, sigurisht nisur nga qëllimet më të mira, por që në të vërtetë më turpëronin sa s'thuhet, atëherë më kaplonte trishtimi dhe në ato çaste shpalosej dhe përligjej e gjithë pazotësia ime në fusha nga më të ndryshmet. Lehtësimin më të madh e provoja kur ti zhvisheshe i pari dhe unë mund të qëndroja në kabinë si për të shtyrë turpin e daljes para njerëzve, derisa vije të shihje ku dreqin isha strukur dhe më zvarrisje jashtë. Të isha mirënjohës sepse nuk dukej se e kuptoje sikletin tim, pastaj ndihesha edhe krenar për trupin e tim eti. Nga ana tjetër, ky dallim qëndron, me të njëjtat ngjyresa, edhe sot e kësaj dite.

Atëherë kjo pasqyrohej edhe në epërsinë shpirtërore. Kishe kapur maja me forcat e tua dhe për rrjedhojë kishe besim të verbër në to. Kjo s'më bënte dhe aq përshtypje në fëmijëri sesa më vonë, kur u rrita. Nga kolltuku ku rrije ulur, mbizotëroje botën mbarë. Vetëm këndvështrimi yt ishte i drejtë, gjithçka tjetër ishte e padrejtë, e çuditshme, çmendurake, anormale. I ushqeje vetes një besim të tillë që, edhe kur përçartje, të dukej sikur të drejtën e kishe në anën tënde. Rastiste që për një problem të caktuar të mos kishe kurrfarë mendimi, por edhe në këtë rast të gjitha mendimet e të tjerëve, doemos, duhej të ishin të gabuar, pa asnjë përjashtim. Fjala vjen, mund të flisje keq për çekët, pastaj për gjermanët, për hebrejtë dhe jo vetëm për raste të veçanta, por në përgjithësi, dhe si përfundim, përveç teje,

të gjithë dilnin të njollosur. Në sytë e mi ishte skicuar figura enigmatike e tiranit, ligji i të cilit i ka rrënjët te personi, jo tek mendimi. Të paktën kjo ishte përshtypja ime.

Edhe në lidhje me mua, e drejta anonte, rëndom, nga ti, jo vetëm kur bisedonim, pasi dialogu thuajse nuk ekzistonte mes nesh, por edhe në realitet. Dhe s'duhet shumë për të kuptuar arsyen: gjithë mendimet e mia i nënshtroheshin shtypjes tënde marrafrymëse, edhe ato që nuk puqeshin me të tuat, madje sidomos ato. Të gjitha idetë, në dukje të çliruara nga thundra jote, ishin, që në shpërgëj, të damkosura nga gjykimi yt negativ; dhe ishte thuajse e pamundur të shfaqje një mendim të pacunguar e të arrirë në një situatë të tillë. Nuk flas këtu për mendime të stërholluara, por edhe për trillet më të papërfillshme fëmijërore.

Mjaft që të lumturohesha nga një çapkënllëk kalamajsh, ta përjetoja atë, të kthehesha në shtëpi, ta tregoja dhe përgjigjja ishte një grimasë ironie, një hepim i kokës, një trokitje e tryezës me noçkat e gishtave apo: "Kam parë gjëra më të bukura se kjo" ose "Ky është caku i mendimeve të tua", "E ç'të hyn në punë kjo?", "Pa shih ç'ngjarje!" Natyrisht, askush nuk thotë që të ngazëlleje pas çdo çilimillëku, duke qenë se kishe hallet e tua. S'e kam aty fjalën. Flas për zhgënjimin që i ngjallje fëmijës pareshtur, si ta kishe qëllim në vetvete, i shtyrë nga karakteri yt kundërshtues dhe, veç të tjerave, ky shpirt kundërshtie forcohej paprerë nga grumbullimi i arsyeve që e shkaktonin, kështu që, në fund të fundit, kundërshtimi të bëhej zakon,

BIBLIOTEKA UAM Nr. Inv. 2037

e shfaqje edhe atëherë kur qëllonte të ishe në një mendje me mua; dhe zhgënjimet e fëmijës nuk ishin dosido, por linin vragë të thellë, pasi shkatoheshin nga ti, autoriteti më i lartë. Guximi, vendosmëria, besimi, ngazëllimi për këtë apo atë ngjarje rezistonin deri në pikën e fundit; kështu, nëse ti ishe kundër, qoftë edhe kur e nuhasja këtë kundërshtim, platitesha; dhe për më tepër, kështu ndodhte me pjesën dërrmuese të veprimeve të mia.

Kundërvënia jote godiste si mendimet ashtu dhe personat. Mjaft që unë të shprehja një farë interesi për dikë – gjë që nuk para ndodhte shpesh, falë karakterit tim- dhe ti ia bëje gropën me fyerje, shpifje e sharje, pa patur pikën e respektit për ndjenjat e mia dhe pa marrë parasysh gjykimin tim. Njerëz të pafajshëm e naivë, si aktori hebre Lowy, ranë viktima të sjelljes tënde. Pa e njohur fare, i ngjisje lloj - lloj nofkash, që më kanë dalë nga mendja, e krahasoje, fjala vjen, me një insekt të shtirshëm, dhe sa e sa herë, kur bëhej fjalë për njerëz të dashur për mua, e kishe në majë të gjuhës proverbin e qenit dhe të pleshtave[6]. Rastin e aktorit e kam të ngulur në kujtesë sepse i mbajta shënim epitetet që i ngjisje, duke shtuar: "Ja sesi flet im atë për mikun tim (të cilin as që e njeh fare), pikërisht sepse është miku im. Mund t'ia përplas në fytyrë sa herë të më qortojë për mungesë dashurie e mirënjohjeje." Asnjëherë nuk e kam kuptuar mungesën e plotë të ndjeshmërisë për dhimbjen dhe turpin që më kaplonte nga fjalët dhe gjykimet e tua, sikur nuk ishe i vetëdijshëm për pushtetin që zotëroje. Sigurisht edhe unë të kam hedhur ndonjë fjalë çapraz, e di

mirë këtë gjë, por nuk arrija dot ta mbaja veten e t'i masja fjalët dhe pendohesha sapo i nxirrja nga goja. Ndërsa ti, me fyerjet e tua, vrisje e prisje, mbarë e prapë, pa kursyer askënd; para teje njeriu e ndjente veten krejtësisht të pambrojtur.

Kështu ishte ndërtuar sistemi yt edukativ. Them se në këtë fushë je me të vërtetë i talentuar; padyshim me një tip të ngjashëm me tëndin edhe mund të të kish ecur, duke e edukuar sipas mënyrës tënde; do ta kish kuptuar logjikën e fjalëve, nuk do ta kish vrarë mendjen për të tjera gjëra dhe qetësisht do të kish bërë atë që duhej. Për mua, një copë çilimi, gjithë çka urdhëroje ishte, padyshim, një porosi qiellore, kurrë s'e kam harruar këtë, dhe bëhej njësia matëse me të cilin gjykoja botën, sidomos ty, dhe pikërisht këtu gabove fund e krye. Meqë në vogëlinë time piqeshim më së shumti në tryezë, rëndom mësimet e tua kishin të bënin me sjelljen time gjatë ngrënies. Duhej të haja ç'më vinin përpara, ishte e ndaluar të shprehja gjykime mbi cilësinë e gatimeve – ndërsa ty, shpeshherë, ta shpifnin, i quaje "pisllëqe"; ajo "kafsha" (kuzhinierja) e kishte katranosur. Ti, me atë oreks ujku që kishe, gjithë dëshirë për të gëlltitur kafshata të mëdha që s'i lije gjellët as të ftoheshin, haje me babëzi dhe doje që fëmija të nxitonte; në tryezë mbretëronte heshtje mbytëse që thyhej nga yshtjet: "Ha njëherë, pastaj fol!", ose "Jepi, më shpejt, më shpejt!", apo "Pa shih, unë kam kohë që kam mbaruar!" Ishte e ndaluar të kërpisje kockat, por ti e bëje, nuk lejohej të shijoje uthullën por ti e shijoje për shtatë palë qejfe.

Veprimi më i rëndësishëm ishte prerja e bukës në feta të rregullta, por s'prishte punë që ti e prisje me thikën të zhyer në salcë. Duhej patur kujdes të mos binin thërrime në dysheme, dhe zakonisht thërrimet gjendeshin, sidomos, në këmbët e tua. Në tryezë duhej menduar vetëm për të ngrënët, por ti pastroje dhe prisje thonjtë, mprihje lapsat, kruaje veshët me kruajtëse dhëmbësh.

Baba, shpresoj të më kuptosh drejt, këto ishin vogëlsira të papërfillshme; për mua bëheshin cingëritëse vetëm kur ti, njeriu që ishe zot në sytë e mi, nuk u përmbaheshe urdhrave që më kishe diktuar. Për rrjedhojë bota, për mua, ndahej në tri pjesë në të parën unë, skllavi, jetoja nën trysninë e ligjeve të hartuara vetëm për mua, të cilave s'ua dija kuptimin dhe nuk arrija t'u përshtatesha, pastaj ekzistonte një botë e dytë, pafundësisht e largët nga imja, në të cilën jetoje ti, ku drejtoje, caktoje urdhrat dhe zemëroheshe kur nuk zbatoheshin dhe, së fundi, një botë e tretë, ku njerëzia jetonin të lumtur, pa marrë urdhra dhe pa iu bindur kurrkujt.

Sidoqoftë, ndjenja e turpit nuk më ndahej, më vinte turp kur përmbushja urdhrat e tua, pasi vlenin vetëm për mua; më vinte turp kur tregohesha kokëngjeshur, sepse i tillë isha karshi teje, ose nuk isha në gjendje të përshtatesha, sepse s'kisha as fuqinë as oreksin dhe as zhdërvjelltësinë tënde, gjëra që t'i i kërkoje nga unë, pasi i vlerësoje si diçka të natyrshme; dhe ky turp më përvëlonte qenien. Kështu nuk viheshin në lëvizje mendimet, por ndjenjat fëmijërore.

Situata e përjetuar prej meje, asokohe, ndoshta qartësohet më shumë nëse e ballafaqoj me atë të Feliksit. Ti e trajton atë në të njëjtën mënyrë, madje zbaton të njëjtën metodë edukative, që merr ngjyra mizore, kur, sipas teje, tregohet i paedukatë në tryezë; dhe nuk mjaftohesh me shprehjet që m'i thoje mua dikur: "Je një derr i vërtetë!", por shton: "Një Herman i vërtetë", ose "S'i ke lënë gjë tyt eti!" Ndoshta – më shumë se "ndoshta" s'mund të them - kjo Feliksit nuk i lë ndonjë mbresë të dhimbshme, pasi ti s'je veçse gjyshi i tij, pa dyshim figurë e rëndësishme, por nuk je gjithçka, siç ke qenë për mua dhe veç kësaj Feliksi është tip i qetë, i pjekur në një farë mënyre; ndoshta e bezdis zëri yt bubullues por kjo ndjesi nuk i zgjat shumë dhe, për më tepër, jeton me ty për periudha të shkurtra kohe, është nën ndikimin e të tjerëve, të sheh si një figurë të çuditshme e zbavitëse, nga e cila mund të zgjedhë ç'ti pëlqejë. Ndërsa për mua nuk ishe i tillë, s'kisha mundësi të zgjidhja, duhej të merrja gjithçka nga ti. Dhe pa patur mundësi për të debatuar, sepse kurrë nuk ke ditur të diskutosh qetësisht për çështje që nuk të shkonin për shtat, ose që thjesht nuk ishin ide të tuat; karakteri yt autoritar nuk ma lejonte një gjë të tillë. Vitet e fundit, mbase ishte neuroza kardiake, nga e cila vuaje, shkaku i sjelljes tënde; s'mund të them se më parë ke qenë ndryshe, ndoshta neuroza kardiake të jep të drejtën për ta ushtruar më dhunshëm autoritetin tënd, për të varrosur çdo lloj kundërshtimi që të bëhet. Mos ma merr si qortim këtë, s'është veçse një vëzhgim i realitetit ekzistues. Lidhur me

Otlën, fjala vjen: "S'mund t'i thuash një fjalë se të hidhet në fyt", thua zakonisht, por në fakt nuk është ajo që hidhet e para; ti ngatërron faktet me personat; janë faktet që i ke para syve, faktet që i paragjykon menjëherë, pa e dëgjuar tjetrin; vërejtjet që të bëhen nuk të duken bindëse dhe s'bëjnë tjetër veçse të acarojnë. Dhe e mbyll me fjalët: "Bëj ç'të duash; unë nuk të detyroj; je në moshë të pjekur, s'kam ç'këshillë të të jap." Të gjitha këto i thua me zë të mbytur, i zymtuar dhe i murrëtyer nga tërbimi, zë që sot më tremb më pak se në vogëli dhe kjo thjesht sepse ndjenjës së fajit që kam përjetuar atëherë ia ka zënë vendin një ndjesi pafuqishmërie që na ka mbërthyer të dyve.

Pamundësia për të komunikuar qetësisht me ty çoi në një rrjedhojë logjike: u çmësova të flas. Ka gjasa që kurrë të mos bëhesha një orator i zoti, por njëlloj rrjedhshmërie në të folur mund edhe ta kisha fituar. Ndërsa ti, shumë shpejt, fillove të ma ngecje fjalën në fyt; kanosja jote: "Nuk dua kundërshtime!"dhe ajo dora e ngritur s'më shqiten nga mendja edhe sot e kësaj dite. Në praninë tënde – kur flitet për gjëra që të përkasin, bëhesh fanatik i madh- ndodhte që të belbëzoja e të më merrej goja, kjo të bezdiste tej mase, dhe unë atëherë e qepja, në fillim ndoshta nga inati, pastaj sepse s'isha në gjendje as të mendoja e as të flisja. Dhe meqë ti ishe edukatori im i vetëm, pasojat janë pasqyruar në të gjitha fushat e jetës time.' Është një keqkuptim i çuditshëm fakti që, sipas teje, unë s'ditkam të jem i bindur. "Kundërshtimi i përhershëm" kurrë nuk ka qenë parim i ekzistencës time, edhe pse ty të është ngulitur

kjo ide dhe vazhdimisht më qorton. Përkundrazi: nëse do të tregohesha më rebel, sigurisht, do të kishe mbetur më i kënaqur prej meje. Ndoshta metodat e tua edukative kanë qëlluar në shenjë; asnjë hap nuk jam shmangur; ky që jam sot (përjashto, padyshim, prirjet natyrore dhe ndikimet e jetës), është rezultat i edukimit tënd dhe i brishtësisë time. Nëse, gjithsesi, rezultati nuk ta mbush syrin, aq sa në mënyrë të pavetëdijshme kërkon ta mohosh, ndodh pikërisht sepse dora jote dhe qenia ime, lënda që duhej ngjizur, ishin aq të huaja për njëra-tjetrën. Ti shpreheshe: "S'dua kundërshtime!", që të ndrydhje tek unë shtysat e kundërshtisë që të acaronin së tepërmi, por reagimi yt ishte tejet i ashpër dhe unë isha fort i brishtë; bëhesha vuv, strukesha dhe guxoja të lëvizja vetëm kur gjendesha mjaft larg teje, aty ku pushteti yt nuk arrinte më.

Por ti ndiheshe i kërcënuar dhe gjithçka të dukej se e kishe "kundër", ndërkohë që ishte e natyrshme pesha e forcës tënde dhe dobësisë time.

Mjetet e tua edukative rezultative, apo le të themi që ndikonin te unë, tejçoheshin në formën e kërcënimit, fyerjes, ironisë, me një të qeshur dashakeqe dhe çuditërisht plot përdëllim për veten.

S'mund të them me siguri –s'më kujtohet- të më kesh fyer haptas, me sharje të rënda. S'kishe pse ta bëje, në fund të fundit. Zotëroje shumë mjete të tjera, pastaj, sharjet e lëshuara sa majtas-djathtas, në shtëpi e sidomos në dyqan, që më bombardonin nga të gjitha anët, më shurdhonin veshët e njomë prej vocrraku dhe më dukej sikur binin mbi

mua, pasi ata që ti i fyeje nuk ishin më të këqinj se unë, që mbase ta bëja borxh më shumë se ata. Edhe në rrethana të tilla dilte në dritë mungesa e ndërgjegjes dhe përgjegjësisë nga ana jote; s'lije njeri pa sharë dhe nga ana tjetër s'i pranoje dhe i dënoje sharjet që lëshonin të tjerët.

E kishe zakon që sharjet t'i përforcoje me kërcënime; kështu ma bëje edhe mua. Më shkonin shtatë nga shprehja: "Do të të bëj copë e çikë, siç qërohet peshku", edhe pse e dija se asgjë e tmerrshme nuk do të ndodhte (gjithsesi kur je i vogël edhe tronditesh), sepse kjo përkonte me fantazinë time për fuqinë që zotëroje, duke besuar se ishe i zoti t'i vije në jetë këto kërcënime. Më kallje datën kur vrapoje, duke sokëllitur, përqark tryezës për të më kapur, sigurisht në shaka e sipër, por kjo përshtypje krijohej dhe dukej sikur viktima shpëtonte falë ndërhyrjes së mamasë. Përsëri fëmijës i krijohej përshtypja se merrte frymë falë teje dhe ta kishte borxh jetën. E plotësojnë këtë tablo edhe kanosjet kur tregohesha kryeneç. Kur merrja përsipër të bëja diçka që nuk të pëlqente dhe më paragjykoje si dështak, frika nga gjykimi yt ishte e tillë sa, ndoshta kohë më vonë, dështimi ndodhte në të vërtetë. Humba besimin në forcat e mia. U bëra i paqëndrueshëm, dyshues. Me moshën shtoheshin edhe provat që më fshikulloje fytyrës, për të treguar pazotësinë; dhe pak nga pak, në një farë mënyre, fillove të kesh të drejtë. Megjithatë matem mirë para se të them që u bëra ky që jam falë teje; ti vetëm sa i mëshoje diçkaje që realisht ekzistonte, por i mëshoje gjithë

vendosmëri, pasi ishe i gjithëpushtetshëm dhe këtë pushtet e shtrydhje mbi mua deri në pikën e fundit.

Ushqeje një besim të skajshëm në vlerën e ironisë, një element tejet i përshtatshëm i epërsisë tënde karshi meje. Kështillat, zakonisht, i formuloje në këtë mënyrë: "S'mund ta bësh këtë? Është diçka e vështirë për ty, apo jo? Natyrisht, do të të hajë shumë kohë" e kështu me radhë. Çdo pyetje ishte e shoqëruar nga një zgërdheshje dashakeqe dhe nga një çehre e ngrysur. Në një lloj mënyre ndihesha i ndëshkuar para se ta kuptoja ç'të keqe kisha bërë. Tingëllonin shpotitëse edhe ato qortime të tërthorta dhe dukej sikur nuk vleja as për t'u marrë drejtpërdrejt në pyetje; fjala vjen, kur i drejtoheshe mamasë që ndodhej aty, me një ton gati solemn, ndërkohë që e kishe me mua: "Padyshim, s'mund të presësh gjë nga ky zotëria këtu" e kështu me radhë. (Këtu e ka zanafillën frika ime për të të pyetur drejtpërdrejt, gjë që më vonë, krejt logjikisht, m'u bë zakon edhe në prani të mamasë. Për një fëmijë ishte më pak e rrezikshme të pyeste tërthorazi mamanë, që rrinte përbri teje, për gjëra që lidheshin me ty, dhe i thoja: "Si është babai?", duke iu shmangur, në këtë mënyrë, të papriturave). Kishte raste kur miratohej edhe ironia më therëse, me fjalë të tjera, kur binte mbi dikë tjetër, mbi Elin, për shembull, me të cilën, për vite me radhë, ke patur marrëdhënie tejet të ndera. Për mua ishte një hare dashakeqe, një ngazëllim i hidhur, tek shihja t'i vërsuleshe thuajse sa herë uleshim për të ngrënë: "Dhjetë

metra larg tryezës duhet të rrijë ajo dosë" dhe kur shihja tek përqeshje në karrige, si i ndërkryer, duke u skërmitur gjithë tërbim, pa pikën e taktit dhe mirësjelljes, mënyrën sesi ajo qëndronte ulur, që, sipas teje, ngjallte neveri. Sa e sa herë janë përsëritur skena të tilla, apo të ngjashme me këtë dhe sa pak rezultat kanë dhënë. Ndoshta sepse nuk ia vlente barra qiranë të cingërisje nervat për çikërrima të tilla; të krijohej përshtypja se zemërimi nuk shkaktohej nga diçka e papërfillshme, siç ishte qëndrimi i Elit në tavolinë, por lëvrinte që më parë në ajër dhe këto çikërrima s'ishin veçse pretekste që ai të shpërthente me gjithë rrapëllimën e tij. Të bindur, tashmë, se pretekste të tilla, doemos, do t'i gjeje, filluam të mos e vrasim mendjen shumë dhe kanosjet e pareshtura krijuan te ne një lloj mospërfilljeje. Kishim kohë që ndiheshim të sigurtë se nuk do të na rrihje. Kështu fëmijët rriteshin turivarur, të shkujdesur, kryeneçë, gjithnjë të mbërthyer nga dëshira për t'u strukur diku, duke u mbyllur në vetvete. Kështu vuaje ti, vuanim edhe ne. Nga këndvështrimi yt, kishe shumë të drejtë kur, me nofullat e shtrënguara dhe atë qeshje të mllefosur, që mua, si fëmijë që isha, më ngjallnin pamjet e ferrit, e kishe zakon të thoshe gjithë hidhërim (siç ndodhi kohët e fundit me një letër të ardhur nga Kostandinopoja): "Ç'shoqëri e bukur!"

Sjellja jote karshi bijve të tu dukej sikur binte ndesh me qarjet e pareshtura. E pranoj se në vogëli nuk ndieja kurrfarë dhembshurie (më vonë, po) dhe s'arrija të kuptoja si mund

ta dëshiroje një gjë të tillë. Ishe i gjithëpushtetshëm; e ç'të hynin në punë dhembshuria apo ndihma jonë? Duhej t'i kishe përbuzur, siç na përbuzje edhe ne. Prandaj nuk u besoja ankesave të tua dhe mundohesha të gjeja ç'fshihej pas tyre. Vetëm më vonë arrita të kuptoj se vërtet vuaje për shkak të fëmijëve të tu, por atëherë ankesat e tua që – në një situatë tjetër - do të ishin pranuar me një ndjeshmëri të çiltër fëmijërore, e gatshme për të të ndihmuar, pa pikë ngurrimi, më ngjanin si metoda edukimi dhe nënshtrimi, jo aq të dhunshme në vetvete, por me pasoja mjaft të dëmshme, sepse e mësonin fëmijën t'i kalonte shkarazi gjëra që, në të vërtetë, duheshin marrë seriozisht.

Fatmirësisht nuk mungonin përjashtimet nga kjo rutinë e mërzitshme, sidomos kur vuaje në heshtje; atëherë dashuria dhe mirësia, me hovin e tyre, kaptonin çdo pengesë dhe të rrëmbenin kokë e këmbë. Rrallë ndodhte, por ishin çaste magjiplota. Fjala vjen, kur pas drekës, ditëve të nxehta të verës, të shihja në dyqan tek koteshe i rraskapitur, me bërryla të pështetur mbi tryezën e punës, apo kur, të dielën, vije me një frymë të na takoje kur ishim me pushime në fshat; ose kur mamaja lëngonte e sëmurë shkreheshe në dënesë, apo kur unë u sëmura, herën e fundit, i aviteshe ngadalë dhomës së Otlës, ku prehesha, qëndroje te pragu, me qafën e tendosur, duke vështruar shtratin dhe ma bëje me dorë, pa dashur të më prishje qetësinë. Ato çaste shkrehesha në lot ngazëllimi dhe ngashërimi m'i rrëmbush sytë edhe sot e kësaj dite, teksa shkruaj këto radhë.

Ti di edhe të buzëqeshësh hareshëm, një buzëqeshje e heshtur, miratuese, që e lumturon atë që ka fatin ta provojë. Nuk e mbaj mend nëse në vogëli më ke falur ndonjë të tillë, por pa dyshim do ta ma kesh falur; e përse të ma mohoje, atëherë, një privilegj të tillë, kur ende të dukesha një krijesë e pafaj dhe ku kishe varur shpresa të madha? Po ta shohësh hollë, edhe këto mbresa të ëmbla, s'kanë bërë tjetër veçse kanë shtuar ndjenjën timë të fajit dhe e kanë bërë botën më enigmatike në sytë e mi.

Do të më shkonte për shtat më shumë një realitet më i zakonshëm dhe normal. I shtyrë nga një ndjenjë shpagimi karshi teje, dhe deri diku edhe hakmarrjeje, shumë shpejt fillova të vëzhgoj dhe të ve në dukje disa nga sjelljet e tua qesharake: i mblidhja dhe kapesha pas tyre. Fjala vjen, faktin që të linin gojëhapur personazhe të rëndësishëm apo njerëz që ty të dukeshin të tillë, për shembull, një këshilltar i lartë apo diçka e tillë dhe ty s'të pushonte goja (nga ana tjetër, vuaja, kur shihja sesi ti, babai im, kishe nevojë për t'i ballafaquar vlerat e tua me pohimet e tyre aq pa vlerë dhe ngushëlloheshe me to). Ose kur vëreja dobësinë që kishe për shprehje vulgare, të thëna me zë të lartë, me të cilat shqyheshe gazit, sikur të ishin shprehjet më të goditura të botës, ndërkohë që s'ishin veçse lapërdhi të palatuara, pa pikë vlere (por ishin njëherazi edhe një tjetër shfaqje e hazdisur e forcës tënde jetësore).

Dhe bëja pareshtur kësisoj vëzhgimesh; më ngjallnin lumturi, ishin burim thashethemesh dhe zbavitjeje. Rastiste që e vije re dhe të kaplonte zemërimi, e quaje keqdashje

dhe mungesë respekti, por besomë, s'ishte veçse një mjet, ndër të tjera i cunguar, për të fituar besim në vetvete, s'ishin veçse shaka, si ato që tregohen për mbretërit apo për zotat, shaka që jo vetëm nuk dëshmonin për mungesë respekti, por ishin pjesë e tij. Nga ana tjetër, edhe ti, nga i njejti pozicion kundrejt meje, je munduar të mbrohesh në një farë mënyre. S'pushoje së përmenduri privilegjet që gëzoja dhe se ç'përkujdesje më rrethonte. Kjo ishte e vërtetë, por s'ma merr mendja se më ka hyrë në punë, duke patur parasysh situatën e atëhershme.

Padyshim, mamaja tregohej shumë e dashur me mua, por unë çdo gjë e shihja në lidhje me ty, pra, me fjalë të tjera, me syze të errëta. Pa e kuptuar as vetë, mamaja luante rolin e shërbyesit në gjueti. Nëse do të kishte gjasa që edukata që më jepje të qëllonte në shenjë, të më bënte të zotin e vetes, duke zhvilluar tek unë ndjenjën e armiqësisë, neverisë, madje edhe të urrejtjes, mamaja e baraspeshonte situatën me mirësinë që rrezatonte, me bisedat plot kuptim (në atë mëdyshjen e fëmijës, ishte ajo idhulli i urtësisë), me ndërhyrjet në kohën dhe vendin e duhur dhe unë rikthehesha në qerthullin tënd, nga i cili, në rrethana të tjera, për fatin e mirë të të dyve, ndoshta do të isha shkëputur. Ose ndodhte që nuk arrinim të merreshim vesh, që mamaja, fshehurazi, të më mbronte prej teje, fshehurazi të më jepte diçka, të më jepte leje, dhe unë në sytë e tu dilja fëmijë burracak, mashtrues, fajtor, që i arrin gjërat me ndërhyrjet e të tjerëve, edhe atëherë kur është në të drejtën e tij.

Dhe, natyrisht, u mësova t'i kërkoj gjërat me të tilla mënyra, edhe kur isha i vetëdijshëm që nuk më takonin. Për rrjedhojë, ndjenja e fajit që provoja u thellua edhe më.

E pranoj, kurrë s'ke vënë dorë mbi mua. Por britmat, fytyra e mavijosur dhe tirandat e lëshuara mbi shpinoren e karriges ishin edhe më zi. Është si puna e atij të dënuarit me varje. Nëse e varin, atëherë vdes dhe merr fund gjithçka, por nëse e detyrojnë të përjetojë gjithë parapërgatitjet e rastit dhe e falin vetëm atëherë kur e ka lakun në fyt, mund të traumatizohet për tërë jetën. Veç kësaj, rastet e panumërta kur, sipas mendimit tënd të shprehur haptas, i kisha hak ca të ngrohta dhe shpëtoja për qime, falë zemërgjerësisë tënde, s'bënin tjetër veçse thellonin edhe më ndjenjën time të fajit. Ngado që ta vërtisje, isha fajtor karshi teje. Gjithnjë më ke akuzuar (qoftë kur ishim vetëm, qoftë në prani të të tjerëve – s'e kishe për pesë të nxirrje zorrët e barkut në sy të të tjerëve, bëmat e bijve të tu mund t'i merrte vesh gjithë bota) se në jetë s'më ka munguar asgjë, se kam jetuar pa kokëçarje, në bollëk dhe shpatullat i kam patur gjithnjë të ngrohta. Më vijnë ndërmend thënie që më janë skalitur në tru, si: "Që shtatë vjeç u bija fshatrave kryq e tërthor, me një karro të vogël", "Flinim të gjithë në një dhomë", "Fluturonim nga gëzimi kur gjenim ca patate", "Vite me radhë kam patur plagë të hapura në këmbë, sepse dimrit, s'vishesha siç duhej", "Isha ende kërthi, kur shkova në dyqanin e Pisekut", "Familja s'më jepte një dysh, as kur isha ushtar, madje u dërgoja unë

të holla", "E megjithatë, babai gjithnjë baba mbetet. Po ku i kuptoni ju, sot, këto? Ku dinë fëmijët e sotëm? Askush s'ka hequr ato që kam hequr unë! E ku kuptojnë këta!" Në të tjera rrethana, këto rrëfime mund të përbënin një metodë të shkëlqyer edukative, mund të ishin një nxitje dhe shtysë për të përballuar vuajtjet dhe mungesat në jetë, siç ke bërë edhe ti, por nuk ishte ky synimi yt; gjithçka kish ndryshuar si nata me ditën, falë përpjekjeve të tua dhe ne s'kishim kurrfarë mundësie për të treguar veten. Një mundësi e tillë mund të bëhej realitet vetëm përmes dhunës dhe sakrificës, fjala vjen, duke ikur nga shtëpia (po të pranojmë se do ta kishim kurajon ta ndërmerrnin një hap të tillë dhe nëna, nga ana e saj, nuk do ta kundërshtonte me të gjitha mjetet e mundshme). Por, padyshim, ti nuk e dëshiroje një gjë të tillë, do ta quaje mosmirënjohje, kryeneçësi, tradhti, çmenduri. Pra, nga njëra anë, na fusje xixat me shembullin dhe rrëfimet e tua, duke na turpëruar, nga ana tjetër, i kundërviheshe iniciativës me të gjitha mënyrat. Në të kundërt, duke patur parasysh rrethanat anësore, aventura e Otlës në Zyrau[7] duhej të të ngazëllente. Ajo dëshironte të jetonte në fshat, aty ku ishte prejardhja jote, donte të përballej me ato vështirësi e mungesa që kishe kaluar ti, s'donte t'i kishte gjërat të gatshme prej teje, siç nuk pate jetuar ti në kurriz të tyt eti. Kaq qëllime dritëshkurtra paskëshin qenë këto? Sigurisht, planet e Otlës qenë fund e krye të dështuar; ato morën ngjyrime qesharake dhe u bë shumë zhurmë

për asgjë, sepse ajo nuk u kujdes sa duhej për prindërit. Po mos vallë vetëm mbi të bie faji, apo edhe mbi rrethanat dhe sidomos mbi faktin që ti ishe shkëputur prej saj? Ndoshta të rrinte më pranë kur punonte në dyqan (siç u mundove t'i mbushësh mendjen vetes më vonë), sesa kur ndodhej në Zyrau?

Dhe je i bindur se nuk do të kishe patur forcë (gjithnjë nëse do ta kishe veten në dorë), të gjeje diçka pozitive në këtë aventurë, me një nxitje, kështillë apo kontroll, ndoshta edhe vetëm duke i bërë ndonjë lëshim?

Duke marrë për bazë rrjedhën e jetës tënde, të ish bërë zakon të thoshe, plot shpoti idhnake, se neve na kish shkuar fjollë. Por në një lloj kuptimi, nuk e kishe aspak me tallje. Ato që ti kishe fituar me luftë, ne i gjenim llokum nga duart e tua, por luftën për bukën e gojës, që ti bëre në të ri, dhe që nuk do të na kursejë as ne, do të na duhet ta bëjmë më vonë, në moshë të rritur, por me fuqinë e kërthiut. Nuk them se gjendja jonë është për të qarë hallin, krahasuar me tënden, madje ndoshta janë të ngjashme (edhe pse pikënisjet janë të krahasueshme), por një mangësi e kemi, dhe është pikërisht fakti që s'mund të mburremi para të tjerëve me mjerimin tonë, s'mund të poshtërojmë askënd, siç ke bërë ti. Nuk dua të mohoj që kam gëzuar frutet e punës tënde të madhe, të kurorëzuar me sukses dhe mund të vazhdoja në gjurmët e tua, por na pengonte fakti se ndiheshim të huaj për njëri-tjetrin. Unë mund t'i shijoja ato çka ti na jepje, duke i paguar me çmimin e turpit,

rraskapitjes, dobësisë dhe ndjenjës së fajit. Me pak fjalë, të isha mirënjohës siç mund të jetë lypësi dhe jo me gjithë shpirt.

Fruti i parë i këtij edukimi ishte shmangia nga gjithçka që kish të bënte me ty. Duke filluar nga dyqani. Në të vërtetë, sidomos kur isha fëmijë, duhet të më rrëmbente të gjithin, me atë gjallëri e atë vezullim që, mbrëmjeve, të merrte sytë; kish plot gjëra për të parë e dëgjuar, nganjëherë edhe të ndihmoja, mund të bëja goxha figurë, por sidomos mund t'i gëzohesha zotësisë tënde prej tregtari, të kundroja si silleshe me klientët, si hidhje e prisje shaka, sa i palodhur ishe, me sa shpejtësi i zgjidhje mëdyshjet dhe shumë gjëra të tjera: mënyrën si i rregulloje pakot dhe si i hapje kutitë ishin një shfaqje që s'duhej humbur dhe një mësim i mirë për ne fëmijët. Por, kur më kallje frikë, në kuptimin e plotë të fjalës, dyqani dhe ti më dukeshin anë të së njëjtës medalje dhe ndihesha i sikletosur. Gjëra, më parë të zakonshme për mua, më mundonin e më mbulonin me turp, sidomos mënyra si silleshe me shitësit. Nuk e di, mbase kështu ndodh në të gjithë dyqanet (fjala vjen, kur punoja te Sigurimet e Përgjithshme, mbretëronte e njëjta gjendje dhe për të dhënë dorëheqjen nxorra një shkak që edhe qëndronte, edhe nuk qëndronte plotësisht; i dhashë të kuptojë drejtorit se nuk i duroja dot sharjet, edhe pse nuk më drejtoheshin mua personalisht; që fëmijë isha shumë i ndjeshëm në këtë pikë), por mua ato nuk më interesonin. Të dëgjoja e të shihja në dyqan tek bërtisje, mallkoje e tërbohesheshi askush tjetër. Dhe s'mjaftoheshe vetëm me sharjet, silleshe si tiran

i vërtetë. Për shembull, kur hidhje nga banaku mallra që nuk doje të ngatërroheshin me të tjera -- vetëm tërbimi që të kaplonte mund të përligjte në një farë mënyre – dhe shitësi ishte i detyruar t'i mblidhte. Apo avazi monoton që i nëpërdhëmbje shërbëtorit të sëmurë me tuberkuloz: "Ende nuk e ka dredhur bishtin ky qen zgjebarak?" Vartësit i quaje "armiq me rrogë" dhe, në fakt, të tillë ishin, por para se të bëheshin të tillë, ti më dukeshe "armiku i tyre që u paguaje rrogën." Dhe aty mora një mësim të rëndësishëm: që ti mund të ishe i padrejtë; që ishe i tillë karshi meje, s'mund ta kuptoja aq herët, ndjenja e fajit që më rëndonte në ndërgjegje bënte që e drejta të ishte gjithnjë në anën tënde; por në dyqan, me gjykimin tim prej vocërraku, gjykim që, me kalimin e kohës, shumë pak ndryshoi, shihja njerëz që punonin për ne, të mërdhihur nga frika që u kallje. Natyrisht e teproja, por e bëja këtë pasi isha i bindur se atyre njerëzve u shtije të njëjtën frikë që më shtije dhe mua. Nëse do të ishte në të vërtetë kështu, jeta e tyre do të bëhej e padurueshme; por meqë ishin në moshë të pjekur dhe me nerva të çelikta, fyerjet e tua i hidhnin prapa krahëve, pa e çarë shumë kokën dhe, kështu, ai që prekej më shumë në këtë mes, isha unë. Dyqanin nuk e shihja dot me sy, më sillte ndërmend marrëdhënien që ekzistonte mes nesh: pa folur për interesat tregtare dhe sjelljen tënde demoniake prej biznesmeni, të dukej vetja i plotfuqishëm ndaj kujtdo që kish mësuar diçka prej teje, saqë asgjë nuk të kënaqte dhe, për rrjedhojë, ishe përjetësisht i pakënaqur prej meje.

Për këtë arsye mbaja anën e personelit, kjo edhe për faktin se me natyrën frikacake që kisha, nuk arrija të kuptoja sesi mund të hidhje baltë mbi një të panjohur dhe, gjithnjë për shkak të frikës që flinte brenda meje, dëshiroja që mes nesh dhe familjes tonë të vendosej një lloj armëpushimi me vartësit, të cilët, sipas meje, ndiheshin tmerrësisht të idhnuar. Pra, me ta nuk mjaftonte të silleshe me përpikëri dhe normalisht, madje as me një farë përuljeje, por e ndieja për detyrim të ulja veten jo vetëm duke i përshëndetur i pari, por edhe duke ua kthyer përshëndetjen. Dhe nëse unë, një njeri pa kurrfarë peshe, do t'u kisha puthur këmbët, nuk do të mjaftonte për të shlyer mënyrën sesi ti, zotëria fuqiplotë, u vërsuleshe. Kjo marrëdhënie që fillova të krijoj me njerëzit u pasqyrua, me kalimin e viteve, edhe jashtë dyqanit (diçka e ngjashme me këtë, edhe pse jo aq e rrezikshme dhe vendimtare sa ç'ishte për mua, është dobësia që ka Otla për njerëzit e rangut të ulët, shoqëria që ajo ka me shërbëtoret, gjë që të ngre nervat aq shumë e kështu me radhë). Pra, si përfundim, dyqani më futi frikën dhe nuk më ngjallte kurrëfarë interesi që përpara se të filloja gjimnazin, kështu që u shkëputa përfundimisht. Nga ana tjetër, ishte plotësisht jashtë fuqive të mia, duke qenë se, siç pranoje edhe vetë, ishte një punë rraskapitëse. Dhe për më tepër (gjë që sot më prek dhe më bën të turpërohem aq shumë), ngushëllimin për këtë neveri ndaj dyqanit e gjeje duke thënë se më mungonte nuhatja për biznes, se e kisha kokën plot ide intelektuale, e kështu me radhë. Natyrisht

mamasë i bëhej qejfi kur dëgjonte shpjegimet që ishe i detyruar të thoje, madje edhe unë ndihesha mirë. Por nëse me të vërtetë do të kishin qenë "idetë e mia intelektuale" arsyeja e shkëputjes prej dyqanit (të cilin tani dhe vetëm tani, e urrej realisht dhe plot mirësjellje), do të ishte shprehur në tjetër mënyrë, jo duke u rropatur plot ankth e me shpirt ndër dhëmbë në gjimnaz dhe në Fakultetin e Drejtësisë që të përfundoja i ngulur pas tryezës si një nëpunës i rëndomtë.

Duke u larguar prej teje, isha i detyruar të largohesha edhe nga familja, madje edhe nga mamaja. Sigurisht, tek ajo mund të gjeja strehë, por vetëm po ta kisha mirë me ty. Ishte aq e nënshtruar dhe të donte aq shumë, sa nuk mund të më bëhej krah dhe të përbënte një forcë shpirtërore të pavarur, që të më mbështeste në luftën time. Dhe instinkti i djalit nuk gabon, pasi me kalimin e viteve, mamaja u lidh edhe më shumë pas teje dhe, ndërsa mundohej të ruante, zemërdridhur, një lloj pavarësie, gjithnjë e më tepër duke iu nënshtruar ndjenjave dhe jo mendjes së kthjellët, iu përshtat fund e krye gjykimeve e paragjykimeve që ti kishe për fëmijët e tu, sidomos në rastin e ngatërruar të Otlës. Gjithsesi, kurrë nuk duhet harruar ç'pozitë të vështirë e të mjerë kish ajo në familje. Gjithnjë i ka rënë bretku sa në shtëpi e në dyqan, i ka hequr mbi kurriz të gjitha sëmundjet e familjes, por shpërblimi më i madh që ka marrë ishte ankthi që përjetonte duke luajtur rolin e ndërmjetëses mes teje dhe nesh. Me të je sjellë plot dashuri e përkujdesje, por

nga trajtimi në fjalë edhe atë nuk e ke kursyer. S'e kemi lënë të ngrejë kokë, pa kurrëfarë mëshire, si ti, ashtu edhe ne. Për ne, ajo ishte vendi ku shfryheshim, edhe pse nuk e bënim enkas; ishim tërë kohën në gjendje lufte me njeri tjetrin dhe i zbrazeshim asaj. Padyshim nuk qe ndonjë metodë edukimi për t'u marrë shembull, mënyra sesi – natyrisht pa kurrfarë faji - e sfilisje për shkakun tonë. Dhe në dukje, kjo madje përligjte edhe sjelljen tonë kryeneçe ndaj saj. Sa shumë gjëra tonat ka gëlltitur për hatrin tënd dhe anasjelltas, pa përmendur këtu rastet kur kishe të drejtë, sepse ajo na përkëdhelte, edhe pse kjo "përkëdhelje" shpesh ishte një protestë e heshtur dhe e pavetëdijshme kundër sjelljeve të tua. Padyshim, mamaja nuk do t'ia dilte mbanë të duronte një situatë të tillë, po të mos ushqente një dashuri pa kufi për ne dhe po të mos ndihej e lumtur nga kjo dashuri.

Motrat e mia patën një fat thuajse të ngjashëm me timin. Vali, në marrëdhënie me ty, ndihej më e privilegjuar. Ishte më e lidhur me mamanë dhe ashtu si ajo, dinte të të shkonte për fije pa ndonjë mundim të madh. Edhe ti, nga ana jote, e trajtoje me më shumë ngrohtësi, edhe pse në karakterin e saj cilësitë e fisit tonë, ishin tejet të zbërdhylta. Por ndoshta kjo nuk të bënte dhe aq përshtypje; aty ku s'kishte tharm Kafke edhe ti nuk ngulmoje ta gjeje; dhe nuk të brente ideja se nga ky tip mund të nxirrje diçka. E kundërta ndodhte me ne. Për më tepër, kurrë nuk të ka pëlqyer që cilësitë kafkiane të shfaqeshin te gratë. Ndoshta marrëdhëniet

tua me Valin mund të kishin qenë më të mira po të ıos i kishim turbulluar ne.

Ndërsa Eli, është rasti i vetëm i shkëputjes, thuajse të lotë, nga ndikimi yt. Me atë tip që ajo kishte në vogëli, ıuk më shkonte kurrë ndërmend se do të ndodhte një gjë e illë. Ishte aq avdalle, përtace, e mërzitur, e brejtur nga ıdjenjat e fajit, servile, dashakeqe, e plogët, llupëse, ıoprace sa e shihja dhe kurrë si hidhja një fjalë; më kujtonte humë vetveten, të njëjtën mënyrë nënshtrimi ndaj edukatës ënde. Më kallte krupën, sidomos, kopracia e saj, ves që ıdoshta tek unë ishte edhe më i fortë. Kopracia është, ıdoshta, një nga shenjat më të theksuara të mungesës së umturisë; isha aq i pasigurt për gjithçka, sa diçka më dukej imja vetëm kur e mbaja në dorë apo në gojë, ose të paktën, kur e kisha pranë dorës apo gojës, pra pikërisht atë që ime motër, duke patur të njëjtin ves, mundohej të më merrte. Gjithçka ndryshoi kryekëput kur, në moshë ende të re – faktor tejet përcaktues - u largua nga shtëpia, u martua dhe lindi fëmijë; u shndërrua në një tip të gëzueshëm e të shpenguar, të guximshëm e bujar, plot shpërfillje e optimizëm. Është e pabesueshme sesi, thuajse e anashkalove këtë ndryshim dhe nuk e vlerësove si diçka të mirë, sepse je i verbuar nga mllefi që gjithnjë ke ushqyer dhe ende ushqen për Elin, edhe pse tani e ke humbur pushtetin mbi të, pasi ajo nuk jeton më me ne dhe dashuria që ushqen për Feliksin apo simpatia për Karlin e kanë zbutur mjaft këtë ndjesi.

Vetëm Gerti[8] e provon herë - herë mbi kurriz.

Për Otlën thuajse nuk guxoj të shkruaj; më duket sikur do të ve në rrezik gjithçka kam dashur të shpreh me këtë letër. Në rrethana të zakonshme, pra kur nuk gjendesh në situata të vështira apo të rrezikshme, ndjen për të vetëm urrejtje; ti vetë e ke pranuar se ajo, me dashje, vazhdimisht të zemëron dhe të bën të vuash, dhe kur ti vuan për shkak të saj, ajo ndihet e kënaqur dhe i bëhet zemra mal, si një demon i vërtetë. Kushedi ç'hon i frikshëm duhet të jetë krijuar mes jush, që arritët në një moskuptim kaq të tmerrshëm. Otla është aq larg teje sa thuajse nuk arrin ta shohësh dhe më kot gënjen veten kur mendon se po i afrohesh. Duhet të pranoj se me të, të ka hasur sharra ne gozhdë. Ende shumë gjëra mbeten të vagullta për mua, në këtë rast kaq të koklavitur, por është e qartë, ajo ka në deje gjak Lowy dhe nga Kafkat ka trashëguar armët më të forta. Mes meje e teje, kurrë nuk pati luftë të shpallur; unë u theva shumë shpejt dhe s'më mbeti veçse t'ia mbath dhe të brehem nga hidhërimi, brenga dhe lufta e brendshme shpirtërore. Por ju të dy ishit gjithnjë të gatshëm për t'u kacafytur, gjithnjë plot forca të përtërira për beteja të reja. Një shfaqje madhështore e pikëlluese njëherësh. Fillimisht ishit pranë njëri-tjetrit, sepse edhe sot e kësaj dite, nga ne të katërt, Otla është, ndoshta, shembëllimi më i përkryer i bashkimit mes teje dhe mamasë si dhe i forcave që ndikonin te ju të dy. Nuk e di cilët mund të jenë shkaqet e prishjes së mirëkuptimit atë e bijë, kam përshtypjen se ka ndodhur diçka e ngjashme me historinë time. Ti, nga njëra anë, me

karakterin tënd prej tirani dhe ajo, nga ana tjetër, me atë kryeneçsinë, ndjeshmërinë, shqetësimet, dëshirën për drejtësi, të trashëguar nga Lowy, dhe e gjitha kjo e ushqyer nga forca e vetëdijshme kafkiane. S'ka dyshim që edhe një kam ndikuar tek ajo, por jo në mënyrë të vullnetshme; vetëm për faktin se ekzistoja në këtë botë. Nga ana tjetër, Otla hyri e fundit në marrëdhëniet e ndera, që tashmë ishin krijuar dhe arriti të krijojë një gjykim të pavarur, falë materialit që kishte ndër duar. Sipas meje, për një farë kohe ajo është mëdyshur nëse duhej të hidhej në anën tënde apo të kundërshtarëve dhe sipas gjasave, ti nuk dite ta shfrytëzoje mëdyshjen, madje e flake tej rastin që t'u dha. Megjithatë, nëse kushtet do të ishin pjekur, do të përbënit shembullin e një harmonie të përsosur. Unë do të kisha humbur një aleat, por shpalosja e mirëkuptimit tuaj do të më kënaqte sa s'thuhet dhe falë gëzimit të pakufi që do të të jepte mirëkuptimi, të paktën, me njërin prej bijve, ti do të kishe ndryshuar për mirë karshi meje. Gjithsesi, e gjithë kjo tashmë s'mbetet veçse një ëndërr. Tani Otla nuk ka më kurrfarë lidhje me ty, duhet ta gjejë vetë rrugën e saj dhe falë atij besimi, sigurie, shëndeti dhe shpërfilljeje që zotëron dhe mua më mungon, për ty ajo është më e keqe dhe e pabesë nga ç'mund të jem unë. Të kuptoj mirë: nga këndvështrimi yt, ajo s'mund të jetë veçse kështu. Edhe ajo vetë arrin ta shohë veten me sytë e tu, ta kuptojë dhimbjen që të kaplon dhe në mos qoftë e dëshpëruar – dëshpërimi më shkon përshtat vetëm mua - është tejet e pikëlluar. Në

kundërshti të hapur me gjithë këtë, na sheh shpesh bashkë tek pështërisim, qeshim dhe herë-herë zëmë në gojë edhe emrin tënd. Të dukemi si komplotistë të paskrupullt. Komplotistë të çuditshëm. Në fakt ti, si gjithnjë, je tema kryesore e bisedave dhe mendimeve tona, por, në të vërtetë, ne bashkohemi jo për të të punuar ndonjë rreng, por për të shqyrtuar bashkërisht, duke vrarë mendjen për të kaluar kohën, plot seriozitet, dashuri, zemërim, ngurrim, durim, brerje ndergjegjeje, me tërë forcën e zemrës dhe të mendjes tonë, këtë proces të tmerrshëm që rëndon mes nesh dhe teje, për ta analizuar në hollësitë më të imëta, nga gjithë këndvështrimet, nga larg e nga afër, në këtë proces ku ti gjithnjë mban vendin e gjykatësit, ndërkohë që edhe ti, në një masë të madhe (dhe këtu po i pranoj të gjitha gabimet që, padyshim, do të kem bërë), ashtu si ne, je po aq i dobët dhe i verbuar.

Në gjithë këtë kontekst, një shembull tejet kuptimplotë i pasojave të metodave të tua edukative ka qenë Irma. Nga njëra anë ishte një e huaj, që hyri vonë në dyqan, që ka patur me ty, kryesisht, marrëdhënie pune, pra, e provoi vetëm pjesërisht ndikimin tënd dhe ishte në një moshë që mund të vetëmbrohej; nga ana tjetër, ishte, sidoqoftë, pjesëtare e fisit, që të respektonte si vëllanë e të atit dhe ti ushtroje mbi të shumë më tepër se thjesht pushtetin e shefit. Ishte vërtet shëndetligë, por ishte aq e aftë, e mençur, e vullnetshme, e thjeshtë, e denjë për besim, besnike, që të donte si xhaxha dhe të admironte si shef, kurse ti asnjeherë nuk e trajtove më

humë sesa një vartëse, edhe pse, si në fillim ashtu dhe në vonë, gjithnjë u dallua në punë. E shtyrë edhe nga ıe, ajo mundohej të sillej si të ishte jot bijë, pavarësisht e edhe ajo u fundos nga pesha marrafrymëse e karakterit ënd, që ndikoi aq shumë sa filloi të shfaqë (por vetëm ıë marrëdhënie me ty dhe pa provuar dhimbjen e thellë :ë birit) mungesë vëmendjeje, shpërfillje, ironi lashakeqe, madje edhe një lloj kryeneçësie, për aq sa nund t'ia dilte mbanë. Duhet mbajtur parasysh që ishte shëndetligë, e palumtur, e zhgënjyer nga gjendja në familje.

Për mua, thelbin më kuptimplotë të marrëdhënieve me të e ke mishëruar në një thënie gati proverbiale për ligësinë e saj, por që zbulon papërgjegjshmërinë tënde në mënyrën si i trajton njerëzit: "Ajo zonjë e nderuar më ka lënë këtu një haur derrash."

Mund të vazhdoj të përshkruaj sferat e ndikimit tënd dhe betejën për t'iu kundërvënë atyre, por të dhënat do të ishin disi të vagullta dhe do të më duhet t'i përtërija edhe një herë ngjarjet nga ana tjetër, sa më shumë shkëputesh nga dyqani dhe familja, aq më i sjellshëm, i mirëkuptueshëm, bujar, i kujdesshëm dhe i interesuar bëhesh (flas për pamjen e jashtme), tamam si një diktator që, sapo kapërcen kufijtë shtetërorë, nuk ka më arsye për të qenë tiran dhe tregohet i dashur edhe me njerëzit më të përvuajtur. Dhe, po të shohësh fotografitë e bëra në Franzenbad, ngrihesh madhështor dhe i hareshëm mes atyre njerëzve të vegjël e turivarur, tamam si mbreti në

udhëtim. Në ato çaste, edhe bijtë e tu mund të përfitonin, por – gjë që ishte e pamundur - me mendjet e tyre foshnjore duhet të dinin t'i shfrytëzonin ato dhe unë gjendesha gjithnjë i shtrënguar në qerthullin, si të thuash më të brendshëm, më të ngushtë të ndikimit tënd, siç ka ndodhur në realitet. Kështu, jo vetëm humba ndjesinë e familjes, siç thua ti; përkundrazi vazhdoj ta ruaj, por një ndjesi, në thelb, negative, për shkak të shkëputjes së madhe (që, padyshim, kurrë nuk u plotësua), prej teje. Por ndikimi yt ishte edhe më shkatërrues në marrëdhëniet me njerëzit jashtë familjes. Je krejtësisht i gabuar nëse mendon se, për hir të dashurisë dhe çiltërsisë, unë do t'u bëhem krah me çdo kusht të tjerëve dhe, i shtyrë nga ftohtësia dhe tradhtia, nuk do t'ua jap hakun ty dhe familjes. Po e përsëris për të njëqindën herë: ka gjasa të isha bërë një njeri i pashoqërueshëm dhe i mbytur në ankthe, por nga kjo, deri në pikën ku kam arritur në të vërtetë, rruga është shumë më e gjatë dhe e panjohur. (Deri më tash, në këtë letër, qëllimisht kam heshtur për disa ngjarje, tani e tutje jam i detyruar të mos përmend gjëra të cilat e kam të vështirë të t'i tregoj ty dhe vetes. E them këtë që të mos mendosh se, nëse faktet nuk janë fort të qarta, nuk do të thotë se mungojnë provat; përkundrazi, prova, që do t'i bënin këto fakte të pakapërdishëm dhe aspak të këndshëm, ka sa të duash. Nuk është e lehtë të gjesh mënyrën e përshtatshme për t'i rrëfyer). Nga ana tjetër, mjaft të sjellësh ndërmend ngjarje të largëta: e kisha humbur besimin në vetvete, duke ia lënë vendin një ndjenje faji që s'rrëfehet. (Duke sjellë ndërmend këtë ndjenjë faji

pa anë e pa fund, njëherë shkruajta për dikë: "Trembet se turpi do të bëhet zot i gjithë qenies së vet"). Nuk mund të bëhesha tjetër njeri, sa çel e mbyll sytë, kur isha me të tjerët, madje, para tyre, kjo ndjenjë faji bëhej edhe më gërryese, sepse, siç të kam thënë, më duhej të ndreqja gabimet që bëje në dyqan dhe ku unë ndihesha bashkëfajtor. Ti gjeje gjithnjë diçka për të vënë në lojë të gjithë ata me të cilët shoqërohesha, duke ia thënë në sy ose prapa krahëve dhe mua më duhej t'i kërkoja ndjesë personit të fyer. Mosbesimi që kërkoje të ngjallje tek unë, në dyqan ose në familje, për pjesën dërrmuese të të njohurve të mi (më përmend dikë, që për mua ishte i rëndësishëm në fëmijërinë time, të cilin nuk e ke përgojuar, mëse një herë) dhe që, çuditërisht nuk përbënte për ty kurrfarë pengese (ishe tejet i fortë për t'i bërë ballë dhe në fund të fundit, kjo bëhej një lloj simboli i sundimit tënd). Ky mosbesim, që në sytë e mi prej kërthiu nuk gjente kurrë miratim, pasi ngado shihja vetëm njerëz normalë, u shndërrua në mosbesim ndaj vetes dhe në një frikë të përhershme ndaj gjithçkaje. Sigurisht, nuk ishte kjo mënyra për të shpëtuar prej teje. Nëse nuk e ke kuptuar sesi qëndrojnë gjërat, kjo ndoshta lidhet me faktin se asnjëherë nuk je munduar t'i njohësh ata që kishe përreth dhe me atë mosbesimin dhe xhelozinë tënde (mos vallë po e mohoj faktin se më doje shumë?), mendoje se anë e plotësoja gjetiu mungesën e jetës familiare dhe të dukej e pamundur që unë sillesha në të njëjtën mënyrë edhe jashtë mureve të shtëpisë. Nga ana tjetër, në rininë

time, gjeja të paktën një lloj ngushëllimi, duke vënë në dyshim gjykimet e mia; i thoja vetes: "Ti e tepron, si gjithë të rinjtë i sheh gjërat e parëndësishme vetëm si përjashtime." Me kalimin e kohës, kur e njoha botën më mirë, thuajse e humba këtë lloj ndjesie.

Edhe judaizmi nuk ia doli mbanë të më shpëtonte nga ti. E megjithatë mund të përbënte, në vetvete, një rrugë shpëtimi, madje mund të hamendoj se pikërisht kjo mund të përbënte një pikëlidhje dhe njëkohësisht do të ishte për të dy, një pikënisje e përbashkët. Por judaizmi që mësova prej teje ishte i një lloji krejt tjetër. Në rrjedhën e viteve, kam mbajtur tre qëndrime të ndryshme kundrejt tij. Kur isha fëmijë, në marrëveshje me ty, qortoja veten që nuk shkoja aq sa duhej në tempull, që nuk agjëroja e kështu me radhë. Mendoja se kështu nuk dëmtoja veten por ty dhe ndjenja e fajit, gjithnjë në pritë, më mbërthente të tërin.

Më vonë, në periudhën e djalërisë, nuk e kuptoja sesi ti, me atë judaizmin tënd sa për sy e faqe, më qortoje përse nuk përpiqesha (të paktën për respekt) të bëhesha edhe unë i tillë. Nga ç'shihja, me të vërtetë ishte një punë boshe, një shaka, madje një shaka pa kripë. Shkoje në tempull katër herë në vit, dhe atje më shumë ishe moskokëçarës sesa besimtar; i thoje lutjet si për të larë gojën, madje nganjëherë më çudisje tek më tregoje në libër paragrafin e lutjes që po thuhej, për më tepër, vetëm kur ndodhesha në tempull (kjo ishte kryesorja), mund të dembelosesha për qejf tim. Kaloja orë të stërzgjatura duke gogësitur në përgjumje (aq shumë, vetëm në orët e

mësimit të kërcimit jam mërzitur), duke u munduar të zbavitesha sa mundja me argëtimet që ofronte ceremonia, fjala vjen, hapja e baules që më kujtonte lojën e goditjes në shenjë, pasi edhe atje, kur godisje të zezën, hapej dera e një kutie, por aty, të paktën, dilte ndonjë gjë interesante, ndërsa këtu dilnin gjithnjë të njëjtat kukulla pa kokë. Nga ana tjetër, në kësi rastesh trembesha tej mase jo vetëm nga turma, me të cilën duhej të përziheshim, por edhe sepse njëherë të kishte shpëtuar goja se edhe unë mund të ftohesha në Torah. Vetëm ideja më bënte të dridhesha, për vite të tëra. Përndryshe asgjë nuk e trazonte mërzitinë time, ndoshta vetëm barmizwe[9], që s'kërkonte veçse të mësoje përmendësh disa formula, si të isha në prag të një provimi fare të thjeshtë, dhe përsa të takon ty, më tërhiqje vëmendjen vetëm kur të thërrisnin në Torah dhe ti e kaloje shkëlqyeshëm provën, që mua më dukej një ritual tejet mondan, apo kur, ditën e të vdekurve, qëndroje në tempull dhe mua më dëbonin: për shumë kohë ky fakt, për shkak të përjashtimit dhe mospjesëmarrjes time, krijoi tek unë ndjesinë gati të pavetëdijshme se bëhej fjalë për diçka të padenjë. Kështu ndodhte në tempull dhe në shtëpi, gjërat paraqiteshin edhe më mjerueshëm, duke u mjaftuar vetëm me seder-in[10] e parë që, nën ndikimin e djemve, tashmë adoleshentë, gjithnjë e më tepër merrnin pamjen e një komedie, plot gajasje të shfrenuara. (Përse nuk shkëputeshe nga ndikimi? Sepse ishe ti që e kishe krijuar.) Ky, pra, ishte besimi që kishe përçuar tek unë, dhe kësaj i shtohej dora jote e shtrirë,

që bënte shenjë nga "bijtë e milionerit Fuchs", të pranishëm në tempull bashkë me të atin në rastet e festimeve të rëndësishme. Nuk arrija të kuptoja se ç'mund të bëje tjetër me ato gjëra fetare, përveçse t'i hiqje qafe sa më shpejt të ishte e mundur; dhe akti më i shenjtëruar më dukej pikërisht heqja qafe. Më vonë e vlerësova situatën nga një tjetër këndvështrim dhe e kuptova përse kishe bindjen se edhe në këtë kuptim të tradhtoja aq pabesisht. Nga komuniteti i vogël i atdheut tënd, që ngjasonte me një geto, kishe trashëguar një grimë judaizëm, fare pak, të kuptohemi, që u pakësua edhe më, gjatë shërbimit ushtarak, e megjithatë mbresat dhe kujtimet e rinisë përbënin një bazë të mjaftueshme për një jetë judaike, por ti nuk para kishe dhe aq nevojë për një ndihmë të tillë, pasi rridhje nga një trung shëndetplotë dhe nuk ishe i ndjeshëm ndaj dogmave fetare, përveç rasteve kur lidheshin ngushtë me vlerësimet për bashkëjetesën sociale. Thelbi i besimit që të udhëhiqte në jetë kishte të bënte me saktësinë absolute të opinioneve të shprehura nga një klasë e caktuar sociale hebraike, opinione që shkonin për shtat me karakterin tënd dhe besimin që kishe në vetvete.

Kishe brenda vetes një tharm judaizmi, por tejet të dobët për t'ia përçuar tët biri, shteronte pikë-pikë teksa ia përcillje. Kjo, pasi, nga njëra anë bëhej fjalë për kujtime personale që s'mund të përcillen dhe, nga ana tjetër, kjo lidhej me qenien tënde, që më kallte frikë. Ishte e pamundur ta bindje një kërthi të trembur të vëzhgonte gjithçka me vëmendje të

tendosur e të cingërisur nga frika që ato pak rite të parëndësishme, të kryera në emër të judaizmit, me atë shpërfillje të denjë për zbrazëtinë e tyre, të mund të ishin më kuptimplotë. Për ty kishin kuptim si kujtime të vagullta të kohëve të shkuara, prandaj dhe doje të m'i përcillje, por nuk ia arrije dot, sepse edhe për ty nuk kishin kurrëfarë vlere në vetvete, ia dilje mbanë vetëm me kanosje e kryeneçësi; e gjithë kjo jo vetëm e kishte dështimin brenda, por edhe i jepte krahë zemërimit tënd të shkaktuar nga kokëngjeshja ime, pasi s'doje ta pranoje dobësinë tënde në këtë fushë. Padyshim, nuk është një dukuri rastësore, kështu ka ndodhur me pjesën dërrmuese të brezit të ndërmjetëm hebre, që emigroi nga zona të pazhvilluara, në qytet; ishte një dukuri e natyrshme, por që i acaroi më tepër marrëdhëniet tona, që edhe kështu ishin të tendosura.

E megjithatë edhe në këtë pikë ndihesh i pafaj, njëlloj si unë, por është pafajësi që duhet t'i shpjegosh me karakterin tënd dhe çastet historike, jo thjesht me rrethanat rastësore, pra mos thuaj, fjala vjen, se kishe shumë halle e shqetësime mbi krye dhe s'kishe kohë të merreshe me të tilla gjëra. Në këtë mënyrë, pafajësinë tënde të padyshimtë e shndërron në një qortim të padrejtë ndaj të tjerëve. Si të gjithë rastet, edhe ky përbëhej nga fakte që hidhen poshtë lehtësisht. Nuk bëhej fjalë për të mësuar gjëra dosido, por për një mënyrë sjelljeje të veçantë; nëse judaizmi, tek ti, do të kish qenë më i fortë, edhe shembulli yt do të ishte më kuptimplotë; ky s'është veçse vëzhgim dhe aspak qortim, është thjesht një mbrojtje kundër

qortimeve të tua. Kohët e fundit ke lexuar kujtimet e rinisë së Franklinit. Enkas t'i këshillova për t'i lexuar dhe jo për t'u njohur me teoritë vegjetariane, siç vërejte, plot ironi idhnake, por për të parë marrëdhëniet e autorit me të birin, të përvijuara qartë në kujtimet që i kushtonte atij. Por s'kam ndërmend të hyj në hollësira lidhur me këtë.

Për mënyrën si e koncepton judaizmin u binda edhe më vonë, falë sjelljeve të tua, vitet e fundit, kur t'u duk se po përthellohesha në çështjet hebraike. Po të kemi parasysh se, parimisht, u kundërvihësh interesave që unë shfaq dhe mënyrës sesi e shpreh, edhe në këtë rast ndodhi pikërisht ashtu. Të them të drejtën, mendoja se do të bëje një përjashtim të vogël, të paktën njëherë. Bëhej fjalë për një judaizëm shumë të ngjashëm me tëndin, pra ekzistonte mundësia e krijimit të marrëdhënieve të reja. Nuk e mohoj që, nëse do të kishe shfaqur interes, do më bëje të dyshoja. Nuk mbetem prapa teje, nga kjo pikëpamje. Por kurrë nuk arritëm ta provonim. Ndërmjetësimi im ta bëri judaizmin të padurueshëm, shkrimin judaik të palexueshëm, aq sa të "kallte krupën." Ndoshta kjo kishte të bënte me këmbënguljen tënde që i vetmi judaizëm i ligjshëm ishte ai me të cilin më kishe brumosur në fëmijëri dhe përveç tij nuk ekzistonte tjetër. Por ishte gati e papërfytyrueshme që t'i dilje për zot kësaj ideje. Pra "krupa" (pa marrë parasysh që nuk kishte të bënte me judaizmin por me mua), nënkuptonte që, në mënyrë të pavetëdijshme, e pranoje besimin e dobët fetar që të

karakterizonte dhe edukimin tim të mangët judaik, bëje ç'mundje për t'i flakur tej kujtimet, shpreheshe gjithë urrejtje kundër tyre. Nga ana tjetër, vlerësimet e tua negative lidhur me judaizmin tim të ri e kalonin masën; gjeta në to mallkimin tënd, dhe që të mund të shpaloseshin, ishte e domosdoshme një marrëdhënie e privilegjuar me të tjerët që, në rastin tim, do të të kishte hapur një plagë vdekjeprurëse.

Më e përligjur ishte kundërshtia jote për gjërat që shkruaja dhe ato që, pa dijeninë tënde, kishin të bënin me to. Këtu kisha arritur me të vërtetë të krijoja një hapësirë të pavarur prej teje, edhe pse kjo më ngjasonte paksa me krimbin që, kur i shkelin pjesën e prapme, arrin të çlirojë të përparmen dhe të tërhiqet zvarrë mënjanë. Ndieja njëfarë sigurie, arrija të merrja frymë; kundërshtinë që, padyshim, ushqeje edhe për ato që shkruaja, arrija ta kapërdija. Kokëngjeshja dhe krenaria ime, padyshim që rënkonin falë mënyrës gjëmëmadhe me të cilën i trajtoje librat e mi: "Vëre mbi komodinë!" (zakonisht ishe duke luajtur letra kur të sillja ndonjë libër), por në fund të fundit kjo më shkonte për fije, jo vetëm për shkak të ligësisë që më ngjitej nga thellësia e shpirtit, jo vetëm për shkak të kënaqësisë që përshtypjet e mia për marrëdhëniet tona vërtetoheshin, por sidomos sepse ajo fjali më tingëllonte si një: "Tani je i lirë!" Natyrisht që gabohesha, nuk isha aspak i lirë, ose në rastin më të mirë nuk isha ende i tillë. Në shkrimet e mia flisja për ty, shprehja ato çka nuk arrija të shfreja ballazi për zemrën tënde, ishte një çlirim

prej teje, i vonuar qëllimisht, një çlirim që ti e kishe ideuar, por që përshkonte një rrugë të përvijuar prej meje. E megjithatë sa pak vlente e gjithë kjo! Vlen të përmendet vetëm se ka të bëjë me qenien time - në të tjera rrethana as që nuk do të binte fare në sy- tregon se ka sunduar jetën time, në fëmijëri si parandjenjë, pastaj si shpresë dhe më vonë si dëshpërim, duke ndikuar – le të themi, gjithnjë nën hijen tënde - në vendimet e mia të pakta e të papërfillshme.

Fjala vjen, në zgjedhjen e profesionit. S'ka dyshim, më ke lënë liri të plotë zgjedhjeje, me atë qëndrimin tënd madhështor, madje zemërgjerë, në ato rrethana. Sidoqoftë, edhe në këtë rast, nuk arrite të dalësh nga qerthulli i traditës së shtresës së mesme hebraike, që për ty kishte aq vlera, apo më mirë të themi, nuk u shkëpute nga shkalla e vlerave të shprehura nga kjo shtresë. Gjithsesi, në fund të fundit, keqkuptimi që kish të bënte me personin tim pati edhe anën e vet pozitive.

Nisur nga krenaria atërore, mosnjohja e karakterit tim të vërtetë dhe dobësia ime fizike, gjithnjë më ke cilësuar si tip tejet studioz. Sipas teje, kur isha djalë s'e ndaja librin nga dora dhe më vonë s'reshtja së shkruari. Kjo s'është aspak e vërtetë. Mund të pohoj, pa e tepruar aspak, se shumë pak kam studiuar dhe hiçgjë s'kam nxënë; gjithë këto vite, falë kujtesës së fortë dhe një farë aftësie përqendrimi, diçka më është ngulitur në kokë, s'është edhe aq për t'u çuditur, por sidoqoftë rezultati i përgjithshëm i njohurive, për më tepër thellësia e tyre,

le shumë për të dëshiruar, duke patur parasysh jetën, në dukje të qetë e pa kokëçarje që kam kaluar, sidomos po të krahasohet me thuajse gjithë të njohurit e mi. Është një rezultat i dobët, por që ka shpjegimin e vet. Që kur kam filluar të arsyetoj, jam përpjekur aq shumë të mbaj gjallë statuskuonë time shpirtërore, saqë gjithçka tjetër më dukej e pavlerë.

Gjimnazistët hebrej, këtu te ne, shpesh janë të çuditshëm, sajojnë gjëra që s'ti pret mendja, por një shpërfillje të akullt si imja, e ndrydhur, e pacënueshme, plot dëshpërim naiv, shpesh qesharak, i përmbushur në mënyrë kafshërore, që kish mbërthyer një djalosh plot fantazi të ndezur por të ftohtë, nuk e gjeta tek asnjëri prej tyre; nga ana tjetër, për mua ishte i vetmi mjet mbrojtës kundër rraskapitjes nervore të shkaktuar nga ankthi dhe ndjenja e fajit. Merresha vetëm me vetveten, edhe pse në mënyra nga më të shumëllojshmet.

Për shembull shëndeti im: fillimisht, gjëra pa shumë rëndësi; disa probleme të vogla me tretjen, rënia e flokëve, kurrizi që filloi të më kërrusej e kështu me radhë; gjëra që, me kalimin e viteve, filluan të shtohen, ashtu pak nga pak, derisa përfunduan në një sëmundje të mirëfilltë. Meqë për asgjë s'isha i sigurt, çdo çast kisha nevojë të vërtetoja ekzistencën time dhe meqë asgjë nuk e zotëroja plotësisht, të tërën, në mënyrë të pakundërshtueshme, të përcaktuar nga unë dhe askush tjetër – në të vërtetë e ndieja veten një bir plangprishës - edhe trupi, realiteti më i prekshëm, iu shtua pasigurive të mia; u zgjata kot

së koti, si skërfyell, mezi lëvizja nga mbipesha, shpatullat m'u kërrusën, për fizkulturë as që bëhej fjalë dhe kështu mbeta i ligur; më dukej një mrekulli që ende trupi kryente funksionet e tij, si tretja e mirë, fjala vjen, dhe kjo qe e mjaftueshme për ta prishur, duke u hapur rrugë hipokondrive nga më të ndryshmet, derisa, falë stërmundimit mbinjerëzor që bëra për shkak të planit që kisha për martesë (do të flas më poshtë për këtë), fillova të pështyj gjak nga mushkëritë dhe këtu, pa dyshim, ndikoi edhe apartamenti në pallatin Schonborn, të cilin e mbaja vetëm për nevojat e mia si shkrimtar, prandaj më duhet ta përmend këtu. E gjithë kjo, pra, nuk u shkaktua nga një mbingarkesë pune, siç ke pandehur ti gjithnjë. Vite të tëra i kalova shtrirë në divan, në kokërr të shëndetit, shumë më tepër nga ç'ke ndenjur ti gjithë jetën, përfshi këtu edhe sëmundjet. Kur largohesha me pamjen e njeriut të mbytur në punë, s'bëja tjetër veçse shtrihesha në dhomën time. Rendimenti i përgjithshëm, si në zyrë (ku dembelizmi nuk para bie shumë në sy dhe ishte disi e kufizuar për shkak të ankthit) ashtu dhe në shtëpi, linte shumë për të dëshiruar; po ta kishe kuptuar, do të ishe tronditur vërtet. Ndoshta, si natyrë, nuk jam aspak dembel, por s'kisha nga t'ia mbaja. Aty ku jetoja nuk isha i mirëpritur, ndihesha i gjykuar, i humbur dhe kërkimi i një jete në arrati më rraskapiste sa s'thuhet, por kjo nuk ishte punë, ishin ëndrra të parealizueshme, me përjashtim të disa gjërave të vogla, që i kapërcenin tej mase fuqitë e mia.

Pra, në kushte të tilla m'u dha liria për të zgjedhur profesionin. Por a isha vallë në gjendje ta përdorja këtë liri? A mund të shpresoja se mund të ushtroja një profesion të mirëfilltë? Respekti për veten, më shumë se nga çdo gjë tjetër, varej nga ti për shembull, nga një sukses në jetë. Ky shte vetëm një ngushëllim i çastit, asgjë më tepër, por ishe i, ai që peshoje në këtë mes. Mendoja se nuk do ta kaloja klasën e parë të fillores, përkundrazi arrita, madje, të fitoj edhe një çmim; s'ka dyshim që do të rrëzohem në provimin e pranimit në gjimnaz, thosha me vete, por gjithçka shkoi për mrekulli; me siguri do të ngel në vitin e parë, por as kjo nuk ndodhi, madje pata rezultate të mira. Gjithsesi nuk fitova besim në vetvete, përkundrazi, kisha bindjen – dhe provën më të qartë e shihja në pamjen tënde fodulle - që sa më shumë ua dilja mbanë gjërave, aq më keq do të përfundonin. Shpesh, përfytyroja kolegjin e tmerrshëm të profesorëve (gjimnazi është shembulli më domethënës, ngado ndihesha i rrethuar nga fantazma të tilla), tek mblidhej pas mbarimit të vitit të parë, të dytë, të tretë e kështu me radhë, për të shqyrtuar këtë rast skandaloz dhe të papërsëritshëm: në ç'mënyrë, unë, padyshim më i pazoti dhe më i padituri, kisha arritur deri në atë klasë, pa m'u futur gjemb në këmbë dhe duke qenë se isha bërë aq problem, do të më përjashtonin pa e bërë të gjatë. S'është e lehtë për një djalosh të jetojë i kapluar nga fantazi të tilla. Dhe në kushte të tilla, si mund ta vrisja mendjen për mësimet dhe si mund të isha i zellshëm? Shkolla më interesonte – dhe, në atë moshë, jo vetëm shkolla por gjithçka më

rrethonte - pak a shumë siç i intereson nëpunësit të korruptuar të bankës, që trembet mos i çjerrin maskën dhe humbet vendin e punës, ndaj shpejton t'i kryejë sa më parë punët që i takojnë. Të gjitha këto më dukeshin çikërrima kaq të papërfillshme përpara thelbësores. Kështu vazhdoi deri në maturë, të cilën duhet të pranoj se e mora me mashtrim, të paktën pjesërisht, pra, si përfundim, gjithçka mbaroi: isha i lirë. Nëse deri tani isha marrë veçanërisht me veten, aq më keq tani që isha i lirë. Për mua nuk ekzistonte liri e mirëfilltë në zgjedhjen e profesionit, e dija që gjithçka do të më dukej e papërfillshme përpara problemit thelbesor, njëlloj si me lëndët e shkollës, pra duhej të zgjidhja një punë që, pa e lënduar shumë krenarinë, të më lejonte të ruaja, sa të mundja, indiferencën time. Dhe zgjedhja më e përshtatshme qe jurisprudenca. Bindjen time e përforcuan edhe ca përpjekje të vogla, të cilat i bëra i shtyrë nga krenaria apo nga një shpresë absurde si, fjala vjen, dy javë në një kurs kimie apo gjashtë muaj në një kurs gjermanishteje. Si të thuash, gjatë dy muajve të provimeve, nën një trysni të theksuar nervore, ndikohesha shpirtërisht nga fjalët e të tjerëve. Por në njëfarë mënyre kjo s'më bezdiste, ashtu si kisha bërë, pak a shumë, në gjimnaz dhe siç u mësova më vonë me zyrën, sepse situata u shkonte plotësisht për shtat dëshirave të mia. Sidoqoftë, në këtë rast u tregova tejet i mprehtë, që në vogëli kisha patur ide shumë të qarta lidhur me studimet dhe profesionin. Nga kjo pikëpamje nuk prisja kurrfarë shpëtimi, kisha hequr dorë me kohë.

Nuk kisha bërë asnjë lloj parashikimi paraprak lidhur ne mundësinë e martesës; martesa, e cila ka qenë telashi m më i madh deri më sot, thuajse më erdhi si rrufeja në ıiell të pastër. Zhvillimi i fëmijës kish qenë i ngadaltë, cëto ishin gjëra që s'kishin të bënin me të dhe ai ndihej i nënjanuar; herë - herë ishte i detyruar të mendonte, por që ıuk mendonte se pikërisht në lidhje me këtë, po përgatitej :ë kalonte një provë vendimtare që s'kish të sosur, për të nos thënë më e hidhura. Në të vërtetë, përpjekjet për martesë u shndërruan në përpjekjet më të guximshme e në të tmerrshme për shpëtim, por që përfunduan me një dështim po aq të tmerrshëm.

Duke patur parasysh se gjithçka lidhet me këtë çështje me shkon ters, kam frikë se nuk do të jem në gjendje ta shpjegoj thelbin e këtyre përpjekjeve. Dhe nga kjo varet edhe gjithë domethënia e letrës, sepse, nga njëra anë, mishërohen të gjitha forcat pozitive që zotëroja dhe nga ana tjetër shpërthejnë zemërake forcat e errëta që kam përshkruar, pjellë e edukatës tënde, si, fjala vjen, dobësia, mungesa e besimit në vetvete, ndjenja e fajit, të cilat përbënë një pengesë të mirëfilltë mes meje dhe martesës. E kam të vështirë të jap shpjegime edhe për faktin se s'kam reshtur së bluajturi këtë problem me mendjen time, për ditë të tëra, dhe ende tablonë e kam tejet të turbullt. Sipas meje, të vetmen ndihmë mund të ma japë keqkuptimi i plotë që ke krijuar për çështjen në fjalë; dhe sqarimi i këtij keqkuptimi nuk më duket edhe aq i vështirë.

Pikësëpari, ti i përfshin martesat e mia të dështuara

në vargun e dështimeve të mia të vazhdueshme; dhe nuk të vë faj, mjaft që të pranosh shpjegimet që kam dhënë deri më tash, lidhur me këto dështime. Edhe ai bën pjesë në atë varg, por ti e nënvlerëson rëndësinë e tij dhe e nënvlerëson aq shumë sa, kur bisedojmë mes nesh, në të vërtetë flasim për gjëra krejt të ndryshme. Marr guximin të them se në jetën tënde kurrë nuk ke patur të tilla probleme kaq të rëndësishme sa përpjekjet e mia për martesë. Me këtë nuk dua të them se në jetën tënde nuk ke patur çështje po kaq të rëndësishme, përkundrazi, jeta jote ka qenë e mbushur me ndodhi shumë më të rëndësishme, më të vrullshme, më të gjalla, por pikërisht prandaj nuk të ndodhi ajo që më ndodhi mua. Kjo ngjan me rastin e dikujt që i duhet të ngjisë pesë shkallë të ulëta kurse tjetrit vetëm një, por që atij i duket e lartë sa të pesta shkallët e tjetrit të marra së bashku; i pari do të kapërcejë jo vetëm ato pesë shkallë, por edhe qindra e mijëra të tjera, duke kaluar një jetë të lodhshme plot gjallëri, por asnjëra prej atyre shkallëve nuk do të ketë, për të, rëndësinë e asaj shkalle të vetme, të lartë, të pamundur për t'u kapërcyer, megjithëse personi tjetër, edhe pse përpiqet me mish e me shpirt, as mund t'i afrohet dhe aq më pak ta ngjisë.

Martesa, krijimi i familjes, pranimi i gjithë fëmijëve që mund të vijnë në jetë, kujdesi për të ardhmen e tyre në këtë botë kaq të pasigurt, dhënia e një drejtimi të caktuar, nuk e ve në dyshim që është pikësynimi më i lartë për njeriun. Fakti që, në dukje, shumë njerëz e arrijnë

lehtësisht nuk është një kundërprovë, së pari sepse, realisht, pak prej tyre ia dalin mbanë dhe, së dyti, këta të fundit nuk "veprojnë", s'bëjnë tjetër veçse "i lenë gjërat të rrjedhin"; pra kjo nuk është pikëmbërritja, edhe pse është diçka madhështore, që meriton respekt (sidomos për faktin se në këtë fushë, "veprimi" dhe "rrjedha e gjërave" nuk janë të ndara me thikë). Pra, nuk bëhet fjalë për të arritur në pikëmbërritje, por vetëm për t'iu afruar asaj, edhe pse me përpjekje dinjitoze; në fund të fundit nuk është e nevojshme të fluturosh deri në diell, mjafton të zvarritesh në tokë derisa të gjesh një copëz vend të pastër që e rreh dielli herë pas here dhe ku mund të marrësh një të ngrohur.

Sa i përgatitur isha për këtë? S'kish ku të shkonte më keq. Dhe kjo mund të merret me mendje nga ç'thashë deri më tash. Por përsa i përket përgatitjes së drejtpërdrejtë të individit dhe një ndërhyrjeje po aq të drejtpërdrejtë në lidhje me situatën në fjalë, ndihmesa jote linte për të dëshiruar. Dhe s'mund të ndodhte ndryshe; këtu përcaktues janë zakonet seksuale, të përbashkëta për një shtresë, për një racë dhe një epokë. Sidoqoftë një farë ndërhyrjeje nga ana jote ka patur, jo dhe aq e ndjeshme, kuptohet, sepse kjo do të kërkonte një besim të ndërsjelltë, që prej kohësh na mungonte të dyve, madje edhe në ato çaste aq vendimtare, pasi kërkesat tona ishin tejet të kundërta; shqetësimet e mia që të bëjnë përshtypje dhe anasjelltas, ajo që për ty është naivitet, për mua mund të jetë faj, ajo që për ty s'ka pasoja, mua mund të më asgjësojë fare.

Sjell ndërmend një mbrëmje, isha duke shëtitur me ty dhe mamanë në Josephplatz, afër selisë aktuale të Landerbank dhe me pamje prej kokoroshi, me një ton mendjemadh, madhështor, shpërfillës (por një shpërfillje e rreme), të ftohtë (ashtu ishte vërtet), duke nëpërdhëmbur, siç flisja zakonisht me ty, hapa bisedën për "ato" gjërat, ju qortova që s'më kishit shpjeguar si qëndronin punët, ju thashë se për ato gjëra m'i kishin hapur sytë shokët e shkollës, pasi kisha rrezikuar tej mase (dhe këtu gjënjeja pa pikë turpi, siç e kisha zakon, për t'u treguar garip, ndërkohë që isha aq kokëmushkë për të pranuar se për ato "rreziqet e mëdha" s'kisha veçse një ide të vagullt) dhe në fund të bisedës lashë të kuptohej se tashmë fatmirësisht, dija gjithçka, se këshillat nuk më hynin më në punë dhe gjithçka ishte zgjidhur. Fillova të flas për çështjen në fjalë sepse dëshiroja, të paktën dëshiroja të diskutoja, pastaj edhe i shtyrë nga kërshëria dhe, së fundi, për t'u hakmarrë ndaj jush, nisur nga ndonjë arsye që mbetet e paqartë për mua. Si zakonisht, kjo s'të bëri edhe aq përshtypje, the vetëm se mund të më këshilloje si t'u shmangesha rreziqeve. Ndoshta kërkoja pikërisht një përgjigje të tillë nga ana jote, që t'i shkonte për shtat epshit të një djaloshi të mbiushqyer me mish dhe ushqime nepsndjellëse, të ngathët, që s'mendon veçse për vetveten, por ndihesha aq shumë i prekur në sedër sa, kundër vullnetit tim, e qepa gojën dhe e mbylla bisedën me vrazhdësinë e një fodulli.

Nuk është e lehtë të gjykosh mbi përgjigjen që më dhe asokohe, në të ngërthehet e vërteta lakuriq me qëndrimin

modern, të zhveshur nga paragjykimet. S'mbaj mend sa vjeç isha, jo më shumë se gjashtëmbëdhjetë, s'ka dyshim. Gjithsesi më tingëllonte një përgjigje mbresëlënëse për moshën që kisha dhe hendeku që ekzistonte mes nesh thellohej edhe nga fakti se ky ishte leksioni i parë që më jepje për jetën. Por kuptimi i tij i vërtetë, që atëherë m'u ngulit në mendje dhe që vetëm shumë kohë më vonë m'u rishfaq në mënyrë gjysmë të pavetëdijshme, ishte si vijon: më kështillove, sipas mendimit tënd, që përkonte me mendimin tim të asaj kohe, gjënë më të pistë që mund të mendohet. Shqetësimi yt për faktin që unë të mos sillja në shtëpi gjurmët e këtij pisllëku mbi trupin tim, ishte i dorës së dytë, s'përbënte veçse një përpjekje për të të mbrojtur ty dhe shtëpinë tënde. Por, në thelb, këshillën tënde nuk e zbatoje; ishe një bashkëshort, një njeri qelibar, që qëndroje mbi këto gjëra; dhe për mua, atëherë, ndoshta problemi bëhej edhe më i mprehtë nga fakti që edhe martesa më dukej diçka e pistë dhe e kisha të pamundur të zbatoja te prindërit e mi ato që kisha dëgjuar për këtë. Kështu bëheshe gjithnjë e më shumë qelibar dhe figura jote ngrihej lart e më lart. As që më shkonte nëpër mend që para se të martoheshe mund t'i kishe këshilluar vetes diçka të tillë. Pra, s'kishe asnjë gjurmë pisllëku në qenien tënde. Dhe pikërisht ti, me dy-tri fjalë të rënda, më shtyje në atë pisllëk, sikur ta kisha të shkruar që e kisha vendin aty. Po të ekzistonim vetëm ne të dy mbi këtë tokë, ide në të cilën përkundesha shpesh, dlirësia e kësaj bote do të mbaronte tek ti, dhe falë këshillës tënde, te unë do të fillonte pisllëku.

S'mund ta përfytyroj që të më dënoje në atë mënyrë. S'mund t'i shpjegoja, veçse si pjellë të fajeve të vjetra dhe përbuzjes tënde therëse. Sërish ndihesha i lënduar keqas në thellësinë e qenies time.

Këtu, ndoshta, mungesa e ndërsjellë e fajit, sqarohet me kthjelltësinë më të madhe. A-ja i jep B-së një këshillë të qartë, që pasqyron konceptin e tij për jetën, që ndoshta nuk është e bukur, por e përshtatshme për jetën qytetare të ditëve të sotme dhe që shmang rreziqet ndaj shëndetit. Nga pikëpamja morale, për B-në nuk është një këshillë dhe aq e qëlluar, por mos vallë, me kalimin e viteve, B-ja nuk është në gjendje ta shërojë plagën? Për më tepër që nuk është i detyruar ta ndjekë atë këshillë dhe sidoqoftë nuk ka asnjë arsye për ta patur mbi kurriz gjithë botën e tij të ardhshme. Dhe, megjithatë, ndodh diçka e tillë vetëm për faktin se A-ja je ti dhe B-ja jam unë.

Arrij ta vlerësoj siç duhet këtë mungesë të ndërsjelltë faji edhe për faktin se, pas rreth njëzet vjetësh, mes nesh ka ndodhur një përplasje e ngjashme, në rrethana krejt të ndryshme, një ngjarje e tmerrshme në vetvete, por gjithsesi shumë më pak e dëmshme, sepse tashmë me këto tridhjetë e gjashtë vjet që mbaj mbi supe, pak gjëra mund të më dëmtojnë. E kam fjalën për bisedën e shkurtër, në një nga ato ditët e stuhishme që pasuan planin tim të fundit për martesë. Pak a shumë më the kështu: "Ajo duhet të ketë veshur ndonjë këmishë elegante, vajzat hebreje të Pragës dinë ta luajnë dhe ti, s'ka dyshim që, pa e bërë të gjatë, vendose të martohesh. Madje sa më shpejt të jetë e mundur,

javën tjetër, nesër, sot. S'të marr vesh, dreqi ta hajë, në moshë të pjekur po, nga qyteti po dhe shkon e martohesh me të parën që të del përpara. Nuk e vret mendjen se mund të ketë edhe zgjidhje të tjera? Vij unë me ty, po qe se trembesh." Më haptas e më qartë s'mund të flisje, por hollësitë më kanë dalë nga mendja, ndoshta shikimi më ishte mjegulluar disi, gati e kisha mendjen te mamaja që, edhe pse ishte plotësisht në një mendje me ty, mori diçka nga tryeza dhe doli nga dhoma.

Kurrë më parë fjalët e tua s'më kishin poshtëruar aq shumë dhe kurrë më parë s'ma kishe përplasur fytyrës, në atë mënyrë, përbuzjen tënde. Kur një bisedë të ngjashme ma kishe bërë këtu e njëzet vjet përpara, nga pikëpamjet e tua mund të vërehej, madje, njëlloj respekti për atë djalosh qyteti aguridh, të pjekur tashmë, sipas teje, që e kishte filluar jetën pa u sjellë vërdallë kot së koti. Sot, ato kujtime, s'bëjnë tjetër veçse mund të përforcojnë përbuzjen tënde, pasi ai djelmosh që po merrte hov ka mbetur në vendnumëro dhe nuk ka fituar kurrfarë përvoje; ato njëzet vjet që i rëndojnë mbi shpatulla veçse e kanë rraskapitur. As që e vije ujin në zjarr se ç'vajzë do të zgjidhja. Gjithnjë i kishe vënë shkelmin (në mënyrë të pavetëdijshme), aftësisë time për të vendosur dhe tani ishe i bindur se e dije (gjithnjë pa vetëdije), sesa mund të vlente. S'e kishe fare idenë se ç'përpjekje bëja për të shpëtuar, kështu që as që mund t'i merrje me mend arsyetimet që kishin të bënin me planin tim për t'u martuar, përpiqeshe t'i merrje me mend dhe, duke marrë për bazë gjykimin që kishe për mua, më

kështilloje zgjidhjen më të neveritshme, më të trashë, më qesharake. Pate një farë ngurrimi kur ma shprehe në atë mënyrë. Sipas teje, fyerja që po bëje as që krahasohej me njollën që do të kishte ndotur emrin tënd, nëse martesa në fjalë do të kurorëzohej.

S'ka dyshim që planit tim për martesë mund t'i kundërvije lloj - lloj argumentash, gjë që s'mënove ta bëje: nuk mund ta merrje shumë seriozisht këtë vendim timin, pasi dy herë e kisha prishur fejesën me F. dhe të dyja herët ishim bashkuar, duke të çuar ty dhe mamanë kot së koti në Berlin, për të bërë ceremoninë, e kështu me radhë. E gjithë kjo është e vërtetë, po cilat ishin arsyet?

Synimi që përligjte këto përpjekje s'kishte të sharë: të krijoja një familje dhe të bëhesha i pavarur. Ti, padyshim, s'ishe kundër, por në realitet ndodhi si me atë lojën e fëmijëve ku njëri i shtrëngon tjetrit dorën dhe vazhdon t'i thotë: "Hë pra, ik, pse nuk ikën?" Rasti ynë qe edhe më i ngatërruar, pasi gjithnjë atë "ik" e ke patur me qëllim të mirë dhe, pa e kuptuar, gjithnjë më ke mbajtur pas vetes ose, më mirë të them, nën vete, falë karakterit tënd të fortë.

Që të dyja vajzat ishin zgjedhje rastësore, por qëlloi që doli tejet e goditur. Një tjetër dëshmi e moskuptimit të plotë nga ana jote ishte mendimi i patundur që unë isha frikacak, i lëkundur, mosbesues dhe se këmishat e vajzave, pa një pa dy, do të ma prishnin mendjen të martohesha. Në të dy rastet bëhet fjalë për martesa të llogaritura, në kuptimin që ditë e natë, për vite me radhë herën e parë dhe për muaj të tërë herën e dytë, s'mendoja veçse për martesë.

Asnjëra prej dy vajzave nuk më zhgënjeu. Si atëherë, që doja të martohesha, si tani, s'kam ndërruar mendim për to.

Gjithsesi fakti është që herën e dytë nuk do të vija mend nga e para dhe do të tregohesha mendjelehtë. Rastet ndryshonin nga njëri-tjetri dhe në të dytin, që ishte edhe më i përshtatshmi, pikërisht ato që pata kaluar mund të ishqenin shpresat e mia. Por nuk po hyj në të thella.

Në fund të fundit, përse nuk u martova? Kishte disa pengesa, siç ndodh gjithnjë, por jeta kështu e ka; duhet të dish të pranosh pengesa të tilla. Por pengesa më thelbësore, që, për fat të keq, nuk varej nga një rast i veçuar, ishte pazotësia ime e theksuar shpirtërore për t'u martuar. Këtë e tregon fakti që në çastin që vendos të martohem nuk arrij të vë gjumë në sy, ditë e natë kokën e kam zjarr, resht së etuari, sorollatem i dëshpëruar, si i kalamendur. Dhe nuk anë shqetësimet në vetvete që më katandisin kështu, edhe pse gëlojnë me mijëra të ushqyera nga karakteri im melankolik dhe i ngurtë, e megjithatë nuk janë shkaku thelbësor; s'ka dyshim që e kryejnë si s'ka më mirë punën e tyre mbi kufomën, si krimbat, por nuk është kjo që s'më e të bëj asnjë hap përpara. Është kafshimi cimbitës i nakthit, pafuqisë, përbuzjes për vetveten.

Po mundohem të jem më i qartë: në përpjekjet e mia ndeshen mes tyre, me një forcë që s'mund ta hasësh gjetiu, dy elementë, në dukje të kundërt, që qëndrojnë brenda narrëdhënieve tona. S'ka dyshim që martesa ngërthen në vetvete çlirimin e plotë dhe pavarësinë. Unë do të kisha një

familje, pra qëllimin më të lartë që, sipas meje, mund të arrihet dhe kështu do të barazoheshim; turpi dhe tirania, të rrënjosur tek unë dhe që gjithnjë e nxirrnin kokën, do t'i përkisnin së kaluarës. Do të ishte e mrekullueshme, por pikërisht këtu qëndron edhe thelbi i problemit. Është një qëllim tejet i lartë, aq i lartë sa s'mund të arrihet. Është si puna e të burgosurit që jo vetëm synon të arratiset, gjë që edhe mund ta realizojë, por edhe ta kthejë burgun në kështjellën e tij të fshatit. Po të arrijë të arratiset nuk e bën dot një shndërrim të tillë dhe po ta bëjë këtë nuk arrin dot të arratiset. Nëse dua të çlirohem nga kjo marrëdhënie mbytëse, duhet të bëj diçka, që t'i japë fund njëherë e mirë çdo lloj lidhjeje që kam me ty; martesa do të ishte zgjidhja e shumëkërkuar, do të më krijonte një pavarësi të denjë, por në të njëjtën kohë, është tejet e lidhur me ty. Të kërkosh një rrugë zgjidhjeje ka diçka të çmendur në vetvete dhe çmenduria kërcënon të ndëshkojë çdo përpjekje timen.

Pjesërisht, është pikërisht kjo lidhje e ngushtë që më shtyn drejt martesës. Ëndërroj barazinë që do të vendosej mes nesh, që do ta kuptoje si askush tjetër dhe do ishte aq e bukur pikërisht sepse atëherë unë do të bëhesha i lirë, mirënjohës, i pafaj, i sinqertë dhe ti do të preheshe në paqë, do të hiqje dorë nga despotizmi, do të qetësoheshe dhe kënaqeshe. Por gjithë ajo çka ndodhur nuk duhej të ndodhte, që do të thotë të mos marrim fare frymë mbi këtë tokë.

Ndërsa kështu siç jemi, ajo lidhje më pengon të martohem, sepse mbeti një fushë veprimi tërësisht në duart

e tua. Rastis që të përfytyroj hartën e botës të shpalosur dhe ty, të shtrirë sa gjatë gjerë mbi të. Dhe më duket sikur për jetën time mund të shfrytëzoja vetëm ato pjesë që ti s'arrin t'i mbulosh ose që janë jashtë zotërimit tënd. Dhe, sipas përfytyrimit që kam krijuar për madhështinë tënde, këto pjesë janë të pakta kurse martesa ka mbetur jashtë tyre.

Nuk kam aspak ndërmend të pohoj, dhe krahasimi e tregon një gjë të tillë, që me shembullin tënd më largove nga martesa, siç ndodhi në rastin e dyqanit. Në fakt, ndodhi e kundërta, pavarësisht nga njëfarë ngjasimi mes rasteve. Në bashkimin tuaj unë shihja një model të vlefshëm nga shumë pikëpamje, të pashembullt për nga besnikëria, ndihma e ndërsjellë, numri i fëmijëve që, ndonëse sa më shumë rriteshin aq më shumë andralla ju krijonin, nuk arritën ta cënojnë bashkimin tuaj. Ndoshta pikërisht në shembullin tuaj e ka zanafillën koncepti im kaq i lartësuar për martesën dhe nëse pastaj dëshira ime për t'u martuar nuk u realizua, kjo ndodhi për të tjera arsye. Arsye që i ka rrënjët në marrëdhëniet e tua me bijtë dhe që përbën edhe çështjen që trajton kjo letër.

Ekziston një bestytni sipas të cilës frika nga martesa, herë-herë, varet nga druajtja se mos një ditë bijtë na bëjnë të paguajmë gjithë fajet e kryera ndaj prindërve. Në rastin tim, besoj, kjo s'merr ndonjë rëndësi të madhe, pasi ndjenja ime e fajit lind pikërisht nga ti dhe karakterizohet tej mase nga një veçori e caktuar, madje kjo veçori bën pjesë në atë thelbin e tij torturues, është diçka e

papërsëritshme. Sidoqoftë duhet të them se shembëlltyrën e një djali që s'i ndihej zëri, kaq të mbyllur, pa gjallëri e të tutkunosur as unë s'do ta kisha duruar dhe do të kisha marrë arratinë prej tij, madje po të mos ekzistonin të tjera zgjidhje, do të isha larguar siç bëre ti për shkak të martesës sime. Edhe kjo mund të ketë ndikuar në ngurrimin tim për t'u martuar.

Por shumë më e rëndësishme është frika që ushqej për vetveten. Do ta interpretoja në këtë mënyrë: tashmë e kam përmendur faktin se të shkruarit dhe gjithçka lidhet me të janë përpjekje të vogla për të qenë i pavarur, përpjekje për t'u shkëputur, që përfunduan pa shumë sukses, që nuk qenë bindëse dhe as më shpunë shumë përpara. Gjithsesi është detyra ime ose, më mirë, domethënia e jetës time ka të bëjë me ruajtjen e tyre, që të mos lejoj të kërcënohen nga ndonjë rrezik të cilin jam në gjendje ta spraps, madje ta ruaj edhe nga gjasat se mund të shfaqet një rrezik i tillë. Dhe martesa përbën një mundësi të tillë: sigurisht mund të jetë edhe një mundësi për ndihmë të tejskajshme, por për mua mjafton të përbëjë mundësinë për të qenë një rrezik. E çdo të bëja sikur të ishte vërtet kështu? Si mund ta jetoja një martesë duke qenë nën trysninë e ndjenjës, ndoshta jo të dukshme, por padyshim të pranishme të një rreziku të tillë? Para kësaj mund të kem edhe hezitime, por përfundimi është një i vetëm: duhet të heq dorë. Krahasimi i harabelit në dorë dhe pëllumbit në çati[11], në këtë rast, shkon për shtat vetëm vagullimthi. Në duar nuk shtrëngoj kurrgjë, në çati ka gjithçka, e megjithatë, kështu kanë vendosur kushtet

betejës dhe nevojat e jetës, jam i shtrënguar të zgjedh urrgjënë. Një zgjedhje e ngjashme kjo me atë të profesionit.

Por pengesa më e madhe për martesë është bindja ashmë e ngulitur që, për të mbajtur një familje dhe për ta rejtuar atë duhet të përdor gjithë ç'kam vënë re te ti, me të irat e të këqijat e veta, siç janë gërshetuar fiziologjikisht ë qenien tënde, pra forcë dhe përbuzje për të tjerët, shëndet mbarë dhe një lloj papërmbajtjeje, talent në oratori dhe apërshtatshmëri, besim në vetvete dhe pakënaqësi ndaj tjerëve, sens tiranie dhe sundimi, njohje e njerëzve dhe osbesim ndaj pjesës dërrmuese të tyre dhe, së fundi, lësi që s'kishin të sharë si, zell, këmbëngulje, personalitet, ëndrueshmëri. Nga e gjithë kjo, shumë pak ose aspak gjeja veten time dhe si mund të guxoja të mendoja për martesë ksa shihja që deri edhe ti ishe i detyruar të përlesheshe hpër dhe të dilje i humbur përpara bijve të tu? Është e artë se këtë pyetje nuk e shtroja haptas dhe as i jepja rgjigje, përndryshe do të ishte zgjidhur me një arsyetim thjeshtë duke marrë si shembull burra të tjerë që dryshonin prej teje (le të marrim dikë nga fisi, xhaxha içardin, fjala vjen, që s'të ngjason aspak), që janë martuar kurrfarë problemi; një shembull i tillë dilte e tepronte. or kurrë nuk e kam shtruar një pyetje të tillë, megjithëse kam përjetuar që në fëmijëri. Pa dyshim kjo nuk ka lodhur vetëm në rastin e martesës, e kam bërë edhe për ërat më të papërfillshme. Dhe për këto vogëlsira, ti, me embullin dhe edukatën që më jepje, ashtu siç jam rpjekur të të përshkruaj, ma mbushje mendjen për

paaftësinë time, dhe kur të dilte fjala, qoftë edhe për çikërrimën më të papërfillshme, aq më shumë kjo duhej të vlente edhe për çështje më të rëndësishme, domethënë për martesën. Deri para përpjekjeve për martesë kisha bërë pak a shumë jetë tregtari pa kokëçarje, me shqetësimet dhe parandjenjat e zakonshme, por pa mbajtur ndonjë llogari të rregullt. Arrija të fitoja diçka, të cilën e shumëfishoja dhe e përkundja në fantazinë time, pikërisht për faktin se është diçka e rrallë, pasi zakonisht, çdo ditë del me humbje. Gjithçka regjistrohet, por asnjëherë nuk futet në bilanc. Pastaj vjen dita të bësh llogarinë përfundimtare, pra martesën. Dhe shifrat që duhen llogaritur, të japin përshtypjen se s'ke patur kurrfarë fitimi, por vetëm humbje të madhe. Provo po deshe të martohesh, pa të ikur truri!

Këtu përfundon, tani për tani, jeta ime me ty, së bashku me perspektivat për të ardhmen.

Duke vlerësuar në tërësi arsyet e frikës që më kall, mund të më përgjigjesh: "Ti pohon se unë dal nga situata duke të fajësuar vetëm ty për sjelljen time, por besoj se, pavarësisht përpjekjeve të jashtme, ti e ndërlikon problemin ose, të paktën, e paraqet në dobinë tënde. Fillimisht s'pranon kurrfarë faji dhe largon çdo lloj përgjegjësie dhe deri në këtë pikë veprojmë njëlloj. Por pastaj, ndërsa unë gjithë fajet t'i hedh ty, pikërisht ky është mendimi im, ti do të tregohesh në të njëjtën kohë "tejet inteligjent" dhe "tejet i dashur" duke më shfajësuar plotësisht edhe mua. Natyrisht këtë e bën sa për sy e faqe (dhe nuk kërkon më shumë se kaq) dhe pavarësisht nga fjalët e bukura për karakterin dhe

izikun, kundërveprimin dhe brishtësinë, më jep të kuptoj
e shkaktari i sherrit, në fund të fundit, jam unë dhe gjithë
ka ke bërë s'ka qenë veçse vetëmbrojtje. Me mungesën e
inqeritetit ke arritur një qëllim të trefishtë, duke treguar
ë pari se je i pafajshëm, së dyti se gjithë faji bie mbi mua
lhe së treti se, falë bujarisë tënde, ti jo vetëm je në gjendje
ë më falësh, por edhe të bësh diçka më tepër, pra të tregosh
ë edhe unë jam i pafaj. Kjo mund edhe të të mjaftonte,
or nuk ndodh kështu. Të është mbushur mendja se mund
ë jetosh në kurrizin tim. E pranoj se mes nesh ka patur
deshje, por ka dy mënyra për t'u ndeshur: një mënyrë
avalereske ku, forcat e kundërshtarëve maten në shesh të
ejdanit, ku secili lufton për vete, humb apo fiton për vete;
jetra është lufta e insektit që, jo vetëm të ngul thumbin por
dhe të thith gjakun për të mbijetuar. Ky është një ushtar i
ërtetë karriere dhe i tillë je ti. S'je i zoti të jetosh, por për
'u ndjerë rehat, pa kokëçarje e brerje ndërgjegjeje në
aaftësinë tënde, kërkon të tregosh se unë të paskam thithur
përvetësuar çdo fuqi jetësore. Pra, ç'rëndësi ka që je i
azoti, në fund të fundit gjithë faji bie mbi mua. Shtrihesh
ehat-rehat dhe, nëpërmjet jetës, e le veten në duart e mia,
zikisht e shpirtërisht. Ja, po të jap një shembull: kur kohët
fundit u orvate të martoheshe, dhe këtë e pranon edhe në
ëtë letër, nuk është se e kishe me gjithë mend, por, për të
ios u munduar shumë, doje të bashkohesha edhe unë me
ëtë mungesë dëshirë nga ana jote, duke të penguar të
artoheshe për shkak të "njollosjes"që kjo lidhje do t'i
hkaktonte emrit tim. Por një gjë e tillë as që më shkoi

nëpër mend. Pikësëpari, këtu, si dhe në raste të tjera, nuk doja të "bëhesha pengesë për lumturinë tënde" dhe së dyti, nuk do të doja kurrë që im bir të më bënte një qortim të tillë. E ç'fitova duke u munduar të të le të vendosësh vetë? Gjë prej gjëje. Kundërshtimi im për t'u martuar nuk do të të kishte penguar, përkundrazi, për ty do të kish qenë një nxitje më shumë për t'u martuar me atë vajzë, pasi "përpjekja për t'u larguar", siç e përcakton ti, në këtë mënyrë do të ishte realizuar plotësisht. Dhe, pavarësisht lejes që të dhashë, qortimet e tua s'reshtën, pasi kërkon me çdo kusht të ma hedhësh mua fajin për mosrealizimin e martesës tënde. Por në fund të fundit, këtu dhe në çdo rast tjetër, ke arritur të tregosh që të gjitha vërejtjet e mia ishin të përligjura dhe që mungon ajo më thelbësorja që ka të bëjë me mungesën e sinqeritetit, servilizmin dhe parazitizmin. Mos qofsha i gabuar, por edhe në këtë letër po sillesh si parazit karshi meje."

Po përgjigjem menjëherë: kjo replikë që ndoshta pjesërisht mund të jetë kthyer kundër teje, nuk e ka zanafillën te ti, por tek unë. Po aq e thellë sa mosbesimi që ushqej ndaj vetes, që ti ma ke ngulitur, nuk ngjason me mosbesimin që ke ndaj të tjerëve. Nuk dua të mohoj një replikë të ligjshme që, për më tepër, përmban edhe elementë të rinj për të cilësuar marrëdhënien tonë. Në realitet, natyrisht, gjërat nuk mund të lidhen me provat e parashtruara në letrën time, jeta është diçka që shkon përtej durimit; por me përmirësimet që lindin nga kjo

replikë, përmirësime që as dua e as mund t'i shtjelloj në hollësi, sipas meje, arrihet një përmasë kaq e afërt me të vërtetën sa mund të na sjellë prehje që të dyve dhe të na e lehtësojnë jetën dhe vdekjen.

Franc

SHËNIME

1. Kjo letër, e shkruar nga Kafka në nëntor të 1919-ës, në Schelesen, Çeki, nuk ra kurrë në dorë të personit të cilit i ishte drejtuar. Origjinali është shtypur në makinë dhe korrigjimet janë bërë me dorë, me përjashtim të dy faqeve të fundit, që janë shkruar plotësisht me dorë.

2. Motra më e vogël e Kafkës; dy të tjerat, Eli (Gabriel) dhe Vali (Valerie), citohen më poshtë. Që të trija vdiqën në kampet naziste të përqendrimit, gjatë Luftës së Dytë Botërore.

3. Mbiemri i nënës së Kafkës.

4. Nipi i Kafkës, djali i motrës Eli e martuar me Hermannin.

5. Kunati i Kafkës (Josef Pollak), i shoqi i Valit.

6. "Kush fle me qentë, gdhihet me pleshta"

7. Motra e Kafkës administroi për njëfarë kohe një fermë në rrethinat e këtij qyteti, në Çeki, ku shkrimtari kaloi disa herë pushimet.

8. Feliksi dhe Gerti ishin djemtë e Karl Hermannit dhe të Elit.

9. Fillimi i riteve fetare për meshkujt 13 vjeçarë.

10. Drekë rituale e Pragës hebraike.

11. Fjalë e urtë gjermane "Më mirë një harabel në dorë sesa një pëllumb mbi çati", është e njëjtë me shprehjen tonë "Më mirë vezën sot sesa pulën mot".

kafka

NGA GEORGES BATAILLE

A DUHET DJEGUR KAFKA?

Pak kohë pas përfundimit të luftës, një e përjavshme komuniste, *Action*, hapi një kërkim lidhur me një çështje të çuditshme. Tema ishte: *A duhet djegur Kafka?* Për më tepër kjo pyetje tingëllonte e pakuptimtë, pasi më parë nuk ishin shtruar të tilla pyetje që t'i paraprinin asaj si, fjala vjen: "A duhen djegur librat?" ose, në përgjithësi, "Cilët lloj librash duhen djegur?" Sidoqoftë zgjedhja e redaktorit ishte finoke. Është e tepërt të kujtojmë këtu që autori i *Procesit* është, siç thuhet, "njëri nga gjenitë e epokës tonë." Por numri i shumtë i përgjigjeve tregoi se guximi nuk vajti dëm. Për më tepër, shumë kohë para se të formulohej, kërkimi e kishte marrë një përgjigje, që revista s'mori mundimin ta botojë: që autori jetoi ose, të paktën, vdiq i sfilitur nga dëshira për t'i djegur librat e tij. Sipas meje, Kafka, deri në fund, nuk doli nga qerthulli i pavendosmërisë. Në radhë të parë, ai i shkroi këto libra; dhe duhet marrë me mend që ka kaluar kohë nga dita kur i shkroi dhe kur vendosi t'i djegë. Gjithsesi vendimi i Kafkës ishte i dyshimtë, pasi ia besoi ekzekutimin e dorëshkrimeve njërit prej miqve të tij (Max Brod), i cili e kishte paralajmëruar që nuk e merrte përsipër një barrë të tillë. Pak para se të vdiste, gjithsesi shprehu një vullnet të tillë, në dukje të

ormës së prerë: gjithçka që kish lënë duhej ta përpinin flakët.

Sidoqoftë ideja për të djegur Kafkën, edhe pse ishte një rovokacion, ishte logjike për shpirtin e komunistëve. Këto flakë ë përfytyruara ndihmojnë, madje, t'i kuptosh më mirë veprat e j: janë libra të destinuar të përpihen nga flakët, objekte të cilave mungon, në të vërtetë, djegia nga flaka. Ekzistojnë, por *për t'u ndukur*, sikur të ishin asgjësuar tashmë.

KAFKA, TOKA E PREMTUAR DHE SHOQËRIA REVOLUCIONARE

Ndoshta Kafka ka qenë më finoku ndër të gjithë shkrimtarët: paktën ai nuk u zu në grackë!... Pikësëpari, në dallim nga odernët e tjerë, të qenit shkrimtar ishte pikërisht ajo që ai *shironte*. E kuptoi që letërsia ia mohonte kënaqësinë e pritur he ai pikërisht *këtë donte*; por s'reshti së shkruari. Madje do të hte e pamundur të thuash se mbeti i zhgënjyer nga letërsia. jithsesi ajo nuk e zhgënjeu, krahasuar me qëllime të tjera të undshme. Duhet pranuar se për të, letërsia ishte siç ishte Toka Premtuar për Moisiun.

Ja ç'thotë Kafka për Moisiun[1]: "... fakti që ai arriti ta shohë okën e Premtuar vetëm në prag të vdekjes nuk është i sueshëm. Ky vlerësim i madhërishëm ka një kahje të vetme, ë që deri në ç'pikë jeta njerëzore është një çast i pakryer; i kryer pasi kjo lloj jete (pritja e Tokës së Premtuar), mund të jasë pafundësisht, pa arritur kurrë diçka më shumë sesa thjesht ë çast. Moisiu nuk e arriti kurrë Kananin, jo sepse jeta e tij ate shumë e shkurtër, por sepse ishte jetë njerëzore." Nuk htë vetëm denoncim i kotësisë së një të mire të caktuar, por e

gjithë qëllimeve, pa përjashtim, pa kurrfarë kuptimi: një qëllim është gjithnjë i pashpresë *në kohë*, si peshku në ujë, një pikë e çfarëdoshme në lëvizjen e universit: *meqë bëhet fjalë për një jetë njerëzore*.

A ka diçka që t'i kundërvihet më shumë se kjo qëndrimit të komunistëve? Mund të themi se komunizmi është veprim në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, është veprim që ndryshon botën. Tek ai, qëllimi, pra ndryshimi i botës, i vendosur në kohë, në kohën e ardhme, nënrendit qenien, veprimtarinë e tashme që nuk ka kuptim jashtë një qëllimi të paracaktuar: *kjo botë që duhet të ndryshojë*. Për realizimin e një qëllimi të tillë komunizmi, në parim, nuk nxjerr asnjë lloj pengese. I gjithë njerëzimi është i gatshëm t'ia përkushtojë të tashmen një qëllimi të gjithëpushtetshëm. Dhe askush nuk vë në dyshim vlerën e veprimit, askush nuk mund t'i mohojë veprimit autoritetin vendimtar.

Por e parë hollë, ekziston një rezervë e papërfillshme: ne pranojmë se veprimi nuk na ka penguar kurrë të jetojmë.... Kështu bota e veprimit s'ka shqetësim tjetër përveç qëllimit të paracaktuar. Qëllimet ndryshojnë në varësi të dëshirës, por ndryshueshmëria e tyre, ose më mirë kundërshtia e tyre, ka ruajtur përherë një mundësi për bashkëjetesën individuale. Vetëm një mendje e lajthitur, thuajse e çmendur, heq dorë nga një qëllim, pa gjetur një tjetër më të vlefshëm. Vetë Kafka lë të kuptojë që, nëse u tallën me Moisiun, kjo ndodhi për faktin se, sipas profecisë, ai duhej të vdiste në çastin kur realizoi qëllimin. Por logjikisht shton se arsyeja e dështimit të tij ishte "jeta e tij njerëzore." Qëllimi është shtyrë në kohë dhe koha është e kufizuar: kjo i mjafton Kafkës që ta vlerësojë qëllimin në vetvete si një iluzion. Kjo është kaq paradoksale dhe kaq e kundërt me

ëndrimin e komunistëve (qëndrimi i Kafkës nuk bie ndesh vetëm
ıe shqetësimin politik, për të cilin asgjë s'ka rëndësi përveç
ryerjes së revolucionit), sa duhet të mendohemi mirë lidhur me
ëtë gjë.

NAIVITETI I PËRKRYER FËMINOR I KAFKËS

Kjo nuk është detyrë e lehtë.

Kafka e shprehte gjithnjë mendimin e tij, kur dëshironte t'i
ıoshte gjërat haptas (në ditar apo në faqet e reflektimeve), duke
shndërruar çdo fjalë në grackë (ndërtonte ngrehina të
ezikshme ku fjalët nuk renditen sipas një logjike të caktuar, por
orrollepsen njëra mbi tjetrën, sikur duan vetëm të të çudisin, të
ë fusin në qorrsokak, sikur janë shkruar vetëm për autorin, që
uket sikur s'lodhet së kaluari nga çudia në përhumbje).

Pa dyshim është krejt e kotë t'u japësh një kuptim shkrimeve
ë mirëfillta letrare, në të cilat shpesh shihet ajo që s'ekziston,
he në rastet më të mira shihen ato që, pas gdhendjes, mbeten
ga pohimi interpretativ më i mefshtë[2)].

Pikësëpari duhet t'i shprehim këto rezerva. Gjithsesi, ne, si
ë një labirinth, ndjekim kuptimin e përgjithshëm të ecurisë së
jërave që, pa dyshim, mund të kapet vetëm në çastin kur dalim
ga ky labirinth: dhe atëherë, sipas meje, thjesht mund të themi
e vepra e Kafkës në tërësinë e saj është dëshmi e një sjelljeje
rejt fëminore.

Unë mendoj se pika e dobët e rrjedhës tonë logjike qëndron
ë vlerësimin e naivitetit si një sferë më vete, e cila në njëlloj
nënyre nuk na tingëllon e huaj, por që qëndron jashtë nesh dhe
i e tillë nuk mund të përbëjë dhe as të shprehë të vërtetën e

mirëfilltë, atë që ekziston në të vërtetë. Në mënyrë të ngjashme, përgjithësisht askush nuk e sheh gabimin si pjesë të së vërtetës.... "Është fëminore", apo "joserioze", kjo është e njëjta gjë. Por, fillimisht, të gjithë jemi absolutisht fëminorë madje në mënyrën më të çuditshme, duhet shtuar: dhe pikërisht nëpërmjet këtij naiviteti fëminor, njerëzimi në zanafillën e vet, shpreh thelbin e tij. Për të qenë më i saktë, kafsha nuk është kurrë fëminore, por qëniet e reja njerëzore, me pasionin e tyre, e ndryshojnë drejtimin që i këshillon i rrituri, i cili, nga ana e tij, nuk merr kurrfarë drejtimi. E tillë është bota së cilës i përkisnim dhe që herët e para na dehte deri në kënaqësi me pafajësinë e saj: gjithçka tek ajo, për një çast, shpërfillte arsyen e qenies që e kishte bërë *diçka* (në ingranazhin e kuptimeve sipas të cilave ecën i rrituri).

Nga vetja e tij Kafka la atë që redaktori Klossowski e quajti "skica e një autobiografie"[3)]. Fragmenti ka të bëjë vetëm me fëmijërinë, madje me një aspekt të veçantë të saj. "Kurrë nuk mund t'i mbushësh mendjen, fjala vjen, një djaloshi i cili, në mbrëmje, është zhytur në leximin e një historie tërheqëse, pra s'mund t'ia mbushësh mendjen me diçka që i drejtohet vetëm atij, që të ndërpresë leximin dhe të shkojë të flejë." Ja ç'thotë Kafka më tej: "..... Në gjithë këtë, e rëndësishme është që dënimin që më jepej për shkak të faktit që lexoja gjatë, unë e shtrija edhe në cilësinë time të fshehtë për të lënë pas dore detyrat dhe, rrjedhimisht, pasojat ishin edhe më të rënda." Autori në moshë të pjekur këmbëngul në faktin që dënimi kishte të bënte me shijet që përbënin "veçantinë e djaloshit": shtrëngimi e bënte ose "të urrente atë që e detyronte" ose t'i vlerësonte si të papërfillshme gjërat e veçanta që i ndaloheshin. "..... Nëse unë mbaja fshehur, - shkruan, - njërën prej veçorive të mia, për pasojë urreja vetveten dhe fatin tim, duke u vetëcilësuar i lig ose

dënuar."

Lexuesit e *Procesit* apo të *Kështjellës* s'e kanë të vështirë të hquajnë atmosferën që karakterizon krijimet romaneske të Kafkës. Fajin e të lexuarit e pasoi, në moshë të rritur, faji i të hkruarit. Kur në skenë doli letërsia, qëndrimi i familjes dhe idomos ai i të atit, u karakterizuan nga i njëjti mospëlqim me të ilin shihej leximi. Dëshpërimi i Kafkës qe po aq i madh. Me të rejtë Michel Carrouges ka thënë lidhur me këtë: "Ajo që e drydhte tmerrësisht ishte sidomos trajtimi sipërfaqësor që u ëhej gjërave që atë e shqetësonin më shumë..." Duke folur për jë rast kur përbuzja e të afërmve të tij u shpalos e pamëshirshme, Kafka shprehet: "Qëndrova ulur dhe u përkula mbi atë fletë që 'kishte pikë vlere... por, në të vërtetë, papritur, isha dëbuar ga shoqëria...."[4]

RUAJTJA E GJENDJES FËMINORE

Në karakterin e Kafkës të bën përshtypje dëshira e tij e apërmbajtur që i ati ta kuptonte dhe ta pranonte veprimtarinë tij "fëminore", leximin dhe më vonë letërsinë, që babai të mos zbonte nga shoqëria e të rriturve, e vetmja gjë që mund të ıbetej pa u shkatërruar; që në fëmijëri këtë ai e ngatërroi me ıelbin, me veçorinë e qenies së tij. Babai ishte për të njeriu me ıtoritet, interesat e të cilit shkonin deri te vlera e veprimeve të ektshme. Babai përfaqësonte përparësinë e një qëllimi nga varej ta reale, qëllim të cilit i përmbahet pjesa dërrmuese e të rriturve. ë mënyrë *fëminore* Kafka jetonte, si çdo shkrimtar i mirëfilltë, ën përparësinë e kundërt të dëshirës aktuale. Është e vërtetë ai iu nënshtrua zgjedhës së punës së zyrës, e pranoi zemërthyer,

pa iu ankuar njerëzve që e detyruan të bëjë një punë të tillë, por duke u qarë për fatin e tij të keq. Gjithnjë e ndjeu veten të përjashtuar nga shoqëria, që e përdorte, por e trajtonte sikur të mos kishte kurrëfarë vlere - si një lloj krijese fëminore - pra ashtu siç ai sillej plot pasion të zjarrtë në thellësinë e qenies së tij. I ati i përgjigjej me indiferencën e akullt të njerzve të regjur në punë. Më 1919-ën, Franc Kafka i shkroi të atit, por që fatmirësisht nuk ia dërgoi letrën, pjesë të së cilës i kemi bërë të njohura[5]. "Isha – thotë, - një djalë i mbytur në ankth dhe njëkohësisht kokëngjeshur, si gjithë djemtë dhe pa dyshim edhe mamaja m'i plotësonte tekat; sidoqoftë nuk mund të besoj që kam qenë tip kaq i vështirë, s'mund të mendoj se me një fjalë të ngrohtë, me një mënyrë të qetë për të më "marrë për dore", me një vështrim të ëmbël mund të arrije ç'të doje [.....]. Ti je i zoti ta trajtosh një djalë vetëm sipas natyrës tënde, plot forcë, bujë e zemëratë [.....] Ishe ngritur aq lart me fuqinë tënde, prandaj dhe kishe një besim të verbër në vetvete[....] Para teje, s'mund të bëja tjetër veçse të belbëzoja dhe të flisja si një gagaç... Para teje e kisha humbur besimin në vetvete dhe më kaplonte një ndjenjë faji pa fund e pa krye. Pikërisht duke sjellë ndërmend karakterin e pamatë të kësaj ndjesie, ja ç'shkrova një ditë për dikë: "Ai trembej se mos turpi e pushtonte të gjithin"[6]. Gjithçka që shkruaja bënte fjalë për ty; e ç'kuptim tjetër mund të kishte kjo përveçse rrëkesë së lotëve mbi gjoksin tënd? Në këtë mënyrë unë merrja prej teje një leje të stërzgjatur enkas...."

Të gjithë veprën e tij Kafka do të donte ta titullonte: "Përpjekje për t'u arratisur nga qerthulli atëror."[7] Por nuk duhet të gënjehemi në këtë pikë: në të vërtetë Kafka as që donte të arratisej. Ai donte të jetonte brenda qerthullit, si një i dëbuar. Që në fillim ishte i vetëdijshëm për këtë. Nuk mund të thuash që e kishin

rjashtuar të tjerët, por gjithashtu nuk mund të thuash se ishte tëpërjashtuar. Thjesht sillej në një mënyrë të tillë që të bëhej i durueshëm për mjedisin e veprimtarisë dobiprurëse, lustrialiste dhe tregtare; donte të përkundej në naivitetin e drrës.

Kjo lloj arratisjeje ndryshon thelbësisht nga ajo që trajtohet veprat letrare: është një arratisje e dështuar. Më tepër një ratisje që duhet, që kërkon të dështojë. Ajo që i mungon ratisjes së zakonshme, e cila mjaftohet me një formë kompromisi ıe "mburrjeje", është ndjenja e thellë e fajit, e dhunimit të një gji të pashkatërrueshëm, është kthejlltësia e ndërgjegjes së ımëshirshme ndaj vetvetes. "I arratisuri" i veprave letrare është ë fillestar i kënaqur nga dëfrimet; ai ende nuk është i lirë, nuk htë i tillë në kuptimin e vërtetë të fjalës, sipas së cilës liria htë sublime. Për të qenë i lirë duhet të njihesh si i tillë nga ıoqëria sunduese.

Por në botën e mykur të feudalizmit austriak, e vetmja shoqëri ë mund ta pranonte djaloshin izraelit ishte mjedisi atëror i faristëve, që s'ishte prekur nga shtirja e snobistëve meraklinj as letërsisë. Mjedisi ku fuqia e babait të Francit shpalosej haptas, uke shprehur rivalitetin e ashpër të botës së punës, ku tekat kanë vend dhe në fëmijëri e pranon një lloj naiviteti, që ajo vetë lejon në kufij të caktuar, por e dënon parimisht. Tani duhet aktësuar qëndrimi i Kafkës dhe të shpalosim karakterin e tij kstremist. Ai duhej të pranohej jo vetëm nga autoritetet më pak ë afta për ta bërë një gjë të tillë (meqë - e kishte vendosur pa ıikë ngurrimi - ai nuk do të tërhiqej), por kurrë nuk i shkoi nëpër nend t'i godiste autoritetet në fjalë, madje as t'u kundërvihej. Ai ıuk donte t'i kundërvihej këtij babai që i hiqte mundësinë për të etuar; dhe nga ana e tij nuk donte *të rritej* dhe të ishte *baba*.

Zhvilloi, sipas mënyrës së vet, një luftë të pashoqe për të hyrë në shoqërinë e të atit me gjithë të drejtat që i takonin, por do të kish pranuar vetëm me një kusht: *të mbetej ai vocërraku i papërgjegjshëm që ishte.*

S'reshti së luftuari, deri në frymën e fundit, në një betejë të dëshpëruar. Kurrë nuk pati shpresë: e vetmja mundësi për të hyrë në botën e të atit mbetej vdekja, atëherë kur dhe do të humbte veçoritë e veta (naivitetin, tekat). Këtë zgjidhje e parashtroi në 1917-ën, që u shfaq, pastaj, e shumëfishuar në romanet e tij: "Pra, më duhet t'i besoj vdekjes", deklaron në "Mbeturinë e një besimi. *Kthim te babai.* Dita e madhe e pajtimit.[8]" E vetmja mënyrë, të paktën për të, për të kryer një akt prej babai ishte martesa. Dhe, pavarësisht nga dëshira, hoqi dorë për arsye tejet të forta; dy herë e prishi fejesën. Jetonte "i veçuar nga brezat e mëparshëm" dhe "s'arriti... të bëhet fillesë e një brezi të ri.[9]"

"Pengesa kryesore për t'u martuar - shprehet në "Letër babait", - qëndron në bindjen time të thellë se për të siguruar ekzistencën e një familjeje dhe sidomos për të drejtuar mbarëvajtjen e saj nevojiten doemos gjithë cilësitë që ti zotëron....[10]" Pra le ta themi, duhet qenë ashtu siç je ti dhe të braktisësh atë që jam unë."

Kafka pati ç'të zgjedhë mes skandaleve – naivë, të arsyeshëm - të tekave, të humorit të gjithëpushtetshëm, që nuk synojnë asgjë, që nuk shpien në lumturinë e premtuar dhe kërkimin e lumturisë që të jep veprimtaria dobiprurëse dhe autoriteti mashkullor. Pra provoi të zgjedhë; diti, të paktën, të gjejë rrugën në mënyrë të vetëdijshme, edhe pse u përfshi në ingranazhet e një pune që s'i sillte kurrfarë kënaqësie. Zgjodhi tekat pa mbarim të heronjve të tij, naivitetin e tyre, shkujdesjen e tyre të

:thshme, sjelljen e tyre të pacipë dhe falsitetin e qëndrimit të
e. Me një fjalë, dëshiron që ekzistenca e një bote iracionale,
nethëniet e të cilës nuk janë të renditura, të mbetej një
istencë e gjithëpushtetshme, e cila përmbushet vetëm në çastin
na thërret vdekja.
Ai nuk kërkon rrugëdalje, nuk e pranon dobësinë, pa i dhënë
rfarë shprese vlerës sublime të zgjedhjes së tij, shpresë që do
letyronte të shtirej. Kurrë nuk ndoqi rrugë të tërthorta, duke
kuar privilegjin e seriozitetit për atë çka është sublime. E
ınë tekat që të mundëson pushteti dhe ligji përveçse shfaqje
ı ato të kopshtit zoologjik? Ai e ndjeu se e vërteta, origjinaliteti
kave kërkonte sëmundjen, tjetërsimin deri në vdekje. E drejta,
pohon Maurice Blanchot[11] kur flet për të dhe pikërisht për
›rimin, "arti (teka) krahasuar me veprimin, nuk gëzon të
jta." Botën e gëzojnë ata, të cilëve u është dhënë një *tokë e*
mtuar dhe që, nëse e shohin të nevojshme, punojnë e luftojnë
›ashku për ta arritur. Forca e heshtur dhe e dëshpëruar e
fkës qëndron në moskundërshtimin e autoritetit që i mohonte
ndësinë për të jetuar, qëndron në largimin nga gabimi i
gjithshëm që autoritetit i kundërve lojën e rivalitetit. Nëse ai
s'pranon të nënshtrohet, më në fund, del fitimtar, vetë ai,
:a të tjerëve dhe vetes, ngjason me ata kundër të cilëve ka
tuar, me ata që ushtrojnë autoritet. Jeta fëminore, tekat e
›enguara të gjithëpushtetshme, nuk mund t'i bëjnë ballë
ımfit të tyre. Pavarësia e ka çmimin e vet: i mungon ushtrimi
ıshtetit, që do të thotë veprim, epërsi e së ardhmes mbi të
hmen, epërsi e tokës së premtuar. S'ka dyshim që është e
errshme të mos luftosh për të shkatërruar një kundërshtar të
:r, do të thotë t'i qasesh vdekjes. Për të përballuar këtë tradhti
aj vetvetes, duhet luftuar ethshëm, plot ashpërsi e pa ngurrim:

është e vetmja mënyrë për të ruajtur këtë dlirësi delirante, që s'ka kurrfarë lidhjeje me pikësynimin logjik, që më kot rreket të mbështetet në ingranazhet e veprimit, ajo dlirësi që zhyt në batakun e fajësisë gjithnjë në rritje, të gjithë heronjtë e saj. Askush s'është më i dlirë dhe kontradiktor se K. i *Kështjellës* dhe Jozef K. i *Procesit*. Ky personazh i dyfishtë, "i njëjti në të dy librat, tinëzisht agresiv, pa ndonjë shkak apo përfitim, është mbërthyer nga një tekë rravguese, nga një kryeneçësi e verbër. Ai pret gjithçka nga dashamirësia e autoriteteve të pamëshirshme, sillet si një tip paturpësisht i shthurur m'u në mes të bujtinës (bujtina e funksionarëve), mu në mes të shkollës, me avokatin i tij... në sallën e gjyqit të Pallatit të Drejtësisë.[12]" Babai, në veprën *Dënimi*, vihet në lojë deri në tallje nga i biri, por ekziston siguria e hakmarrjes për shkatërrimin e thellë, fatal, të pavullnetshëm të autoritetit të qëllimeve të tij; por ai që i prin shkatërrimit, duke zgjidhur qentë pa gjetur më parë një vendmbrojtje, i përhumbur në terr, vetë ai, do të jetë viktima e parë. Pa dyshim ky është fataliteti i gjithë asaj që është e pavarur nga pikëpamja njerëzore; pavarësia nuk mund të ekzistojë përveçse në mohimin e vetvetes (mjafton edhe llogaria më e vogël dhe gjithçka shkatërrohet, s'mbetet veçse skllavëria, epërsia e qëllimit dhe e llogaritjes bazuar në të tashmen), ose në çastin e zgjatur të vdekjes. Vdekja është i vetmi mjet për të shmangur gjithëpushtetin e abdikimit. Vdekja e përjashton skllavërinë: te vdekja s'ka më *kurrfarë* gjëje.

UNIVERSI GAZMOR I KAFKËS

Kafka nuk na paraqet një jetë të pavarur: përkundrazi, viktimë e nënshtrimit deri dhe në çastet më tekanjoze, kjo jetë na shpaloset

et e trishtueshme. Erotizmi te *Procesi* dhe *Kështjella* është një
otizëm pa dashuri, pa dëshirë e forcë, një erotizëm i thatë, të
it duhet t'i largohesh me çdo kusht. Por gjithçka bëhet lesh e
Në 1922-in, Kafka shkruan në *Ditarin* e tij[13]: "Kur ndihesha i
naqur, doja të isha i pakënaqur dhe duke përdorur gjithë mjetet
ë tashmes dhe të shkuarës që zotëroja, kërkoja të zhytesha në
ishtim: tani do të doja të kthehem në origjinë. Pra gjithnjë
lihesha i pakënaqur, madje edhe nga vetë pakënaqësia që më
shte kapluar. Është e çuditshme sesi, me disa rregullime të
gla, nga kjo komedi të mund të lindë një realitet. Rënia ime
pirtërore filloi me një lojë çiliminjsh, edhe pse e vetëdijshme
çilimillëkun e saj. Fjala vjen, shtiresha sikur kisha një tik nervor
fytyrë, shëtisja nëpër Graben me duart e kryqëzuara prapa
erkut, një kalamallëk i pështirë, por i kurorëzuar me sukses. E
ëjta gjë ndodhi edhe me evolucionin e mënyrës time të shprehjes
trare, evolucion që, për fat të keq, u ndërpre. Nuk lija gur pa
vizur për t'u ndjerë i palumtur." Ja një pjesë tjetër, e cila nuk
shtë e datuar[14]: "...Nuk mbaj kurrfarë shprese te fitorja, nuk
ë kënaq thjesht lufta për luftë, ajo më gëzon vetëm atëherë kur
shtë rrugëzgjidhja e vetme. Si e tillë, ajo më mbush me një
ëzim që s'rrëfehet, që i tejkalon mundësitë e mia për të dhënë
për të fituar kënaqësi dhe e ndiej që do të humbas jo nga lufta
or nga gëzimi."

Pra, dëshiron të mos jetë i lumtur për t'u ndjerë i kënaqur:
ika më e fshehtë e kësaj palumturie ishte gëzimi aq i thellë,
aqë, siç shprehej edhe vetë, për pak i merrte jetën. Ja ç'thuhet
ë fragmentin që vijon[15]: "Përkula kokën mënjanë: në zverkun e
akuriqtë kisha një plagë që më përvëlonte në shpirt, e shkaktuar
ga një rrufe që zgjat edhe sot e kësaj dite." Rrufeja verbuese-
rufeja që zgjat- padyshim që është shumë më tepër kuptimplotë

sesa depresioni që i paraprin. Dhe kjo pyetje e papritur bën pjesë në *Ditar* (1917)[16]: "Kurrë s'kam arritur ta kuptoj sesi mund të konkretizohet dhimbja brenda dhimbjes; në pikën që, fjala vjen, në rast fatkeqësie apo kur koka më përvëlon e tëra, të mund të ulem për t'i shkruar dikujt: unë nuk jam i lumtur. Madje po të shkoj edhe më tej, jam në gjendje që, nëpërmjet disa zbukurimeve, sipas talentit që s'ka asgjë të përbashkët me mosqenien i lumtur, të sajoj diçka lidhur me temën në fjalë, thjesht ose për antitezë, madje edhe me orkestracione të tëra bashkëpërfytyrimesh. Dhe kjo nuk është gënjeshtër, apo për të lehtësuar dhimbjen, por është shpalosje e forcës që përtërihet në një çast kur dhimbja duket sikur i ka shteruar deri në pikën e fundit gjithë forcat e qenies time që ende ndihet e sfilitur. Pra ku i ka rrënjët kjo përtëritje?"

Ndër tregimet e Kafkës, të paktë janë ata që ngjallin interes si *Dënimi*: "Këtë ngjarje, - thuhet në *Ditar*, më 23 shtator 1912[17], - e kam shkruar me një frymë natën e 22 shtatorit duke u gdhirë 23, nga ora 10 e mbrëmjes deri në 6 të mëngjesit. Me zor tërhoqa që poshtë tryezës, këmbët që më ishin bërë dru nga të ndenjurit ulur. Lodhja dhe gëzimi ishin të tmerrshme, teksa shihja sesi ngjarja shtjellohej para meje, sesi rrjedha e ujit më çonte përpara. Shumë herë gjatë asaj nate, mbajta mbi shpatulla gjithë peshën e vetvetes. Çdo gjë mund të thuhet për idetë që të vetëtijnë në kokë, por për ato më të çuditshmet parapërgatitet një goxha zjarr ku ato zhduken e shfaqen rishtas...."

"Ky tregim, - thotë Carrouges[18], - është historia e një djaloshi që sherroset me të atin për hir të një miku dhe që, në fund, vetëvritet i dëshpëruar. Në pak rreshta, të shkurtra aq sa edhe grindja, përshkruhet mënyra sesi u vetëvra ky djalosh:

Doli vrikthi nga dera dhe kaloi shinat e tramvajit, i tërhequr

a një dorë e padukshme drejt ujit. Iu qep parmakut si barkthati qimit. E kapërceu gjithë zhdërvjelltësi, si një gjimnast i vërtetë kish qenë në të ri të tij dhe me të cilin mburrej familja. zhdonte të mbahej me mish e me shpirt, megjithëse forcat po nin, pikasi midis kangjellave një autobus që po afrohej, zhurma ë cilit do të mbulonte zhurmën e hedhjes së tij në ujë, dhe rtiti ngadalë: "Prindër të shtrenjtë, e megjithatë gjithnjë ju m dashur!" dhe u lëshua teposhtë. Atë çast qarkullimi mbi urë te tejet i dendur."

Michel Carrouges me të drejtë këmbëngul në vlerën poetike fjalisë përmbyllëse. Vetë Kafka i ka dhënë një shpjegim tjetër aks Brodit: "E di, - i thotë, - ç'domethënie ka fjalia e fundit? ar po e shkruaja kisha ndërmend një ejakulacion të unshëm[19]." Ky "deklarim i pazakontë" ndoshta linte të kuptoje ënkuptime erotike"? Përvijonte, ndoshta, "në aktin e të kruarit një lloj kompensimi për dështimin para të atit dhe disfatës ëndrrës së parealizuar për të përçuar jetën[20]?" S'di ç'të them, r nën dritën e këtij "deklarimi", fjalia, po ta lexosh e rilexosh, preh gjithëpushtetin e gëzimit, kalimin madhështor nga qënia *hiç,* si janë *të tjerët* për të.

Ky gjithëpushtet i gëzimit humbet gjithë rëndësinë përpara lekjes[21]. Ankthi e paraprinte – si një lloj ndërgjegjeje e fatalitetit fundit - dhe ishte një mënyrë për ta mbërthyer atë çast dehjeje do të jetë dënimi për vorbullën çliruese të vdekjes. Por mungesa umturisë nuk është vetëm dënim. Vdekja e Georg Bendemann shte, për Kafkën, kuptimin e lumturisë: dënimi i vullnetshëm jaste eksesin që e kishte shkaktuar, por largonte ankthin, duke lhënë babait një dashuri e respekt të përhershëm. Nuk kishte tër mjet për t'i dhënë përnderim. Pavarësia e paguan një çmim tillë, vetëm ajo mund t'i japë vetvetes të drejtën për të vdekur:

nuk mund të veprojë kurrë, nuk mund të kërkojë të drejta që i përkasin vetëm veprimit; dhe veprimi asnjëherë nuk është mirëfilli i pavarur, duke qenë se është gjithnjë në kërkim të rezultatit; veprimi gjithnjë është i nënvarur. A mund të gjendet diçka e paparashikueshme në një lidhje të tillë mes vdekjes dhe kënaqësisë? Por kënaqësia- ajo e vërteta, e zhveshur nga interesi, që i kundërvihet çdo interesi- duke qenë emblema e qenies së pavarur, ka si sanksion vdekjen, që është edhe mjeti.

Gjithçka qëndron në këtë. Gëzimi dhe shkëlqimi nuk krijohen në çastet erotike. Erotizmi shërben vetëm për të shkaktuar çrregullimin. Ashtu si tiku nervor i fytyrës, më të cilët Kafka fëmijë dëshironte "të detyronte fatkeqësinë që të ndodhte" vetëm e keqja e përsëritur dhe jeta e jetuar jo në pozita mbrojtëse çojnë në nevojën e kësaj lufte dhe në atë ankth që të mbërthen për fyti, luftë pa të cilën nuk do të kishte as teprime dhe as falje.

Fatkeqësia dhe mëkati e kanë luftën brenda vetes; luftë në të cilën domethënia dhe virtyti, nuk varen nga kurrfarë rezultati. Pa ankthin lufta nuk do të ishte "e vetmja gjë që mund të bëhej", kështu, Kafka, vetëm në fatkeqësi ndihet "i mbushur... me një gëzim që kapërcen aftësinë e tij për të dhënë apo për të marrë gëzim" - me një gëzim kaq të madh, prej të cilit, dhe jo prej luftës, ai pret *vdekjen*.

GJALLËRIA E HARESHME E FËMIJËS GJENDET NË LËVIZJEN E LIRISË SË GJITHËPUSHTETSHME TË VDEKJES

Në përmbledhjen e botuar, të titulluar *Muri kinez*, njëri prej tregimeve, *Fëmijë në rrugën kryesore*[22], na jep një pamje

paradoksale të gjallërisë së lumtur të Kafkës. Si në të gjithë çastet e përshkruara nga veprat e tij, asgjë këtu nuk ka të bëjë me rendin e vendosur apo me marrëdhënie të përcaktueshme. Gjithnjë e njëjta sfilitje e paformë e mjegullës në erë, herë e lehtë, herë e ngadaltë: asnjëherë një qëllim kuptimplotë për t'u ndjekur, që t'i japë një kuptim mungesës së caqeve kaq të gjithëpushtetshëm. Kafka fëmijë bashkohej me bandën e shokëve me të cilët luante.

"Ashtu kokulur, - shkruan, - e ndërprisnim lojën në mbrëmje. S'njihnim as ditë as natë. Kopsat e xhupave kërcëllinin si dhëmbët nga të fohtët, vraponim duke ruajtur të njëjtën largësi nga njëri-tjetri, me gojën e përflakur, si kafshët e Tropikut. Gjithë turfullima e shkrofëtima, si ata kalorësit e luftërave të lashtësisë, zbrisnim turravrap nëpër rrugica, duke u përplasur me njëri-tjetrin dhe me po atë vrundull i ngjiteshim rrugës kryesore. Disa hidheshin nëpër gropa, por sapo zhdukeshin matanë skarpatit të errët, shfaqeshin sipër në rrugicë, në kufi me fushat dhe na shihnin nga sipër si të ishim të panjohur...."

Kjo pamje e kundërt (ashtu si dielli është e kundërta e mjegullës së papërshkueshme, dhe që gjithsesi përbën të vërtetën e veshur), përmban ndoshta virtytin, ndriçon një vepër në dukje të trishtueshme. Hovi i gjithëpushtetshëm i fëmijërisë, gjithë hare e ngazëllim, u shndërrua, me kalimin e kohës në një lëvizje të përthithur nga vdekja. Vetëm vdekja aq e pakufishme, aq e shkëputur nga "veprimi drejt një pikësynimi" mund të ngrinte peshë dhe të fshihte humorin e trazuar të Kafkës. Me fjalë të tjera, në pranimin e vdekjes ai gjen (brenda këtij caku të ndërvarur nga një qëllim), qëndrimin e gjithëpushtetshëm, që nuk ka kurrfarë pikësynimi, nuk kërkon asgjë dhe sa çel e mbyll sytë fiton sërish vrullin që i jep humbja e përhershme.

Kur kalohej matanë parmakut, kjo bëhej me hovin e një fëmijërie endacake. Qëndrimi i gjithëpushtetshëm dhe i zhytur në faj tregon mungesë lumturie: për aq sa kërkon t'i largohet vdekjes. Por në çastin e vdekjes, pa praninë e një sfide, shtysa plot pasion e fëmijërisë dehet sërish nga liria e pavlerë. Ajo që është e gjallë, e paepshme, nuk e pranonte atë që të jep vdekja, e cila është e vetmja që nuk tërhiqet përpara autoritetit të plotë të veprimit, pa provuar vuajtje.

NË Ç'MËNYRË PËRLIGJET ARMIQËSIA E KOMUNISTËVE

Në veprën e Kafkës mund të vërejmë anën *sociale*, anën *familjare* dhe *seksuale* dhe së fundi edhe anën *fetare*. Por këto vërejtje më duken të papërshtatshme dhe ndoshta janë të tepërta: do të desha të paraqes më tej një mënyrë vlerësimi sipas së cilës të gjithë këta këndvështrime përmblidhen në një të vetëm. Karakteri social i tregimeve të Franc Kafkës s'ka dyshim që mund të shihet vetëm në një perspektivë të përgjithshme. Të arrish të kuptosh te *Kështjella* "epokën e njeriut që nuk vepron" apo "epopenë e të akuzuarit në epokën e burokracisë" te *Procesi*; t'u bashkangjitësh këtyre tregimeve obsesionues *Universin e kampeve të përqëndrimit* të Tousset, nuk është edhe aq e përligjur. Por Carrouges, pasi bën këtë përqasje kalon menjëherë në shqyrtimin e armiqësisë së komunistëve. "Do të ishte e lehtë, - thotë, - të hedhësh poshtë akuzat sipas të cilave Kafka është kundërrevolucionar, nëse ai, si të tjerët, do të ishte mjaftuar me paraqitjen e ferrit kapitalist[23]." Dhe shton: "Qëndrimi i Kafkës është i urryer nga shumë revolucionarë, jo për faktin se ai nuk

akuzon drejtpërdrejt burokratin dhe drejtësinë borgjeze (një gjë
ë tillë revolucionarët do ta kishin bërë me vullnet të plotë):
qëndrimi i tij akuzon çfarëdolloj burokracie dhe pseudodrejtësie[24]."
Ndoshta Kafka donte të vinte para përgjegjësive të tilla institucione,
që do të zëvendësoheshin nga të tjera institucione po aq johumane?
a ç'shkruan përsëri Carrouges: "Mos vallë është kundër
ryengritjes? Ai nuk është as pro as kundër. Vetëm vë në dukje
e njeriu është i shtypur: i takon lexuesit të nxjerrë përfundimet.
nuk është njëlloj si të mos ngresh krye kundër pushtetit të
rryer që i ndalon punonjësit t'i përvishet punës?" Sipas meje,
e *Kështjella*, vetë ideja e kryengritjes është e ndrydhur. Carrouges
di këtë gjë dhe vetë ai pohon më poshtë[25]: "E vetmja kritikë që
mund t'i bëhet Kafkës është skepticizmi që ai shfaq kundrejt çdo
isme revolucionare. Në fakt, ai nuk shtron probleme politike,
or njerëzore dhe përjetësisht postrevolucionare." Por të flasësh
ër skepticizëm dhe të kuptosh në një farë mase problematikën
ë ngre Kafka, në rrafshin në të cilin veprojnë njerëzit politikë,
shtë edhe më e pamjaftueshme.

Larg nga të qenit e paparashikueshme, armiqësia e
omunistëve është thelbësisht e lidhur me të kuptuarin e Kafkës.

Po shtoj edhe diçka. Qëndrimi i Kafkës kundrejt autoritetit të
atit njësohet me qëndrimin kundrejt autoritetit në përgjithësi,
ë rrjedh nga *veprimtaria e efektshme*. Në pamje të parë,
eprimtaria e efektshme, e lartësuar në një sistem të bazuar te
syeja siç është komunizmi, përbën zgjidhjen e gjithë problemeve;
or nuk mund as të dënojë, në mënyrë absolute, as të bëjë lëshime
daj qëndrimit krejtësisht të pavarur në të cilën e tashmja
këputet nga e ardhmja. Kjo është një vështirësi e madhe për
që parti që respekton vetëm arsyen, dhe që te vlerat iracionale,
u përfshihen jeta luksoze, naive dhe jo dobiprurëse, sheh të

fshehur vetëm interesin vetjak. Në kuadrin e komunizmit sjellja e
fëmijës është e vetmja sjellje e gjithëpushtetshme që mund të
pranohet: por kjo s'është veçse ana më pak *e rëndësishme* e
kësaj sjelljeje. Ajo u lejohet vetëm fëmijëve që nuk arrijnë dot
pjekjen e të rriturve. I rrituri, kur i jep një kuptim më të
rëndësishëm naivitetit fëmijëror, kur merret me letërsi, i bindur
të arrijë vlerën e gjithëpushtetit, nuk gjen vend në shoqërinë
komuniste. Në një botë ku individualiteti borgjez është dëbuar
njëherë e përgjithmonë, humori i pashpjegueshëm e naiv i Kafkës,
tashmë në moshë të pjekur, nuk mund të gjejë strehë. Komunizmi
është parimisht mohimi i përsosur, e kundërta e domethënies së
Kafkës.

POR VETË KAFKA ËSHTË NË NJË MENDJE

Kafka nuk do ishte në gjendje të pohonte kurrgjë në emër të
asaj që fliste: ajo ç'ka ai është (dhe nuk është një hiç), qëndron
vetëm në masën në të cilën e dënon veprimtaria e efektshme; ai
s'është veçse mohim i veprimtarisë së efektshme. Prandaj dhe
përulet thellë përpara autoritetit që e mohon, edhe pse mënyra
sesi ai përulet është më e dhunshme sesa një pohim i deklaruar
haptas; përulet duke dashuruar, duke vdekur dhe duke i
kundërvënë heshtjen e dashurisë dhe të vdekjes atij autoriteti që
nuk do të mund ta nënshtronte, pasi pavarësisht nga dashuria
dhe vdekja, ai *hiç* është e pamundur të nënshtrohet, është, plot
gjithëpushtet, ai vetë[26].

SHËNIME

1. *Tagebucher* (1910-1923). Frankfurt a. M.S. Fischer erlag, 1951, faqe 545. Në frëngjisht: *Journal Intime, Suivi de squisse d'une Autogiographie. Consideration sur le Peche'. Medi-tions.* Përkthimi dhe hyrja nga Pierre Klossowski, Grasset, 1949, qe189-190 (19 tetor 1921). Në italisht: *Diari*, përkthimi nga .Pocar, Mondadori, Milano, 1953.
2. Është e vetmja përgjigje që mund t'i jap Josef Gabel, që ë përmend në Critique n.78, nëntor 1953, faqe 595. Cirku i klahomës nuk mjaftoi për të futur në veprën e Kafkës perspektivën storike.
3. F. Kafka, *Hochzeitsvorbereitungen auf dem Lande*, Frankrt a. M. Fischer Verlag, 1953, faqe 227-232. Në frëngjisht: *ournal Intime*, faqe 235-243. Në italisht: *Confessioni e imamgini*, ërkthim i I.A Chiusano, Mondadori, Milano, 1960, faqe 242-247.
4. Michel Carrouges, Franz Kafka, Labergerie, 1949, p.83. *'agebucher*, faqe 40-41.
5. F.K *Brief an den Vater*, në *Hochzeitsvorbereitungen*, p116. Të frëngjisht: *Journal*, faqe 39-49. Në italisht: *Lettera al padre*, në *'onfessioni e immagini*, përkthim i A. Rho, Mondadori, 1960.
6. Bëhet fjalë për personazhin kryesor te *Procesi*, Joseph K., ë duket qartë se imiton pikë për pikë figurën e autorit.
7. Carrouges, Franz Kafka, faqe.85.
8. Op. faqe 114. Shënim i Bataille. *Tagebucher*, faqe 534.
9. Op. faqe 85
10. *Brief an den Vater* faqe 219
11. *La part du Feu, Gallimard*, 1949
12. Carrouges, Franz Kafka, faqe 26-27
13. *Tagebucher*, faqe 561
14. *Hochzeitsvorbereitungen* faqe 339
15. Op. faqe 342
16. *Tagebucher* faqe 530 –531.
17. Op faqe 239.
18. Carrouges, Franz Kafka, faqe 27-28. E rimarrë nga Das Urteil. Në italisht: *Dënimi*, përkthim i G. Zampa, te *Racconti*, Feltrinelli, Milano, 1957.

19. Carrouges, Franz Kafka, faqe 103.
20. Ibid.
21. Mendoj se duhet të përmend këtu një fjali që i takon një libri tjetër: "Gabimisht i kushtojmë një rëndësi shumë të madhe kalimit nga një formë e qenies te tjetra. Falë mungesës së përsosmërisë nga ana jonë, i njohim të tjerët si të ishin "të jashtëm", ndërkohë që ata, jo më pak se ne, janë "të brendshëm". Nëse e shohim vdekjen, zbrazëtinë që ajo lë - ndërkohë që bota është e përbërë vetëm nga gjëra të plota - kjo ngjall tek ne një shqetësim personal. Por vdekja joreale, duke na lënë një ndjesi boshllëku, pikërisht atëherë kur na mbërthen ankthi, na tërheq më tepër, pasi ky boshllëk ka të bëjë me plotësinë e qenies." *Hiçi, boshllëku* apo *të tjerët* i referohen në të njëjtën mënyrë një plotësie pavetore, të pavetëdijshme.
22. *F.K Kinder auf der Landstrasse*, te *Erzahlungen*, faqe 25-29. Në frëngjisht: *Enfances*, tek *La muraille de Chine*, përkthim i J. Carrise dhe A. Valatte, 1950. Në italisht: *Bimbi sulla strada maestra*, përkthim i G. Zampa, te *Racconti*.
23. Carrouges, Franz Kafka, faqe 76.
24. Op. faqe 77.
25. Op. faqe 77-78.
26. Shih më sipër.